



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË

RAPORT I KONSOLIDUAR PËR VEPRIMTARINË FINANCIARE DHE ZBATIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË KORÇË PËR VITIN 2022

PRILL 2023

Tabela e Përmbajtjes

1. Hyrja.....	
2. Kuadri Ligjor.....	
3. Analiza e buxhetit e të ardhurave dhe shpenzimeve 2022.....	
3.1 Analiza e detajuar e burimeve të financimit.....	
- Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore për vitin 2022.....	
- Transferta e pakushtëzuar dhe transferta e pakushtëzuar sektoriale 2022	
- Transferta e kushtëzuar 2022.....	
- Të ardhurat e Institucioneve të Varësisë 2022.....	
3.2 Analiza e detajuar e shpenzimeve për vitin 2022.....	
- Analiza e shpenzimeve Bashkia	
3.3 Analiza e detajuar e shpenzimeve sipas Institucioneve të Varësisë.....	
- Analiza e shpenzimeve NSHP.....	
- Analiza e shpenzimeve NSHMAC.....	
- Analiza e shpenzimeve QAK.....	
- Analiza e shpenzimeve Klubi Shumësportësh.....	
- Analiza e shpenzimeve Shtëpia e Foshnjës.....	
- Analiza e shpenzimeve QRZH.....	
- Analiza e shpenzimeve QDZH.....	

1. HYRJA

Bashkia Korçë ka përgatitur raportin e konsoliduar të zbatimit të buxhetit për vitin 2022, i cili përfshin informacion të detajuar, në lidhje me veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit vjetor të Bashkisë dhe për çdo njësi shpenzuese të saj. Ky raport bazohet edhe në raportin e monitorimit të vitit 2022, pasqyrat financiare vjetore, duke ruajtur krahasueshmërinë me planet e buxhetit vjetor.

Gjatë vitit 2022, Bashkia Korçë është fokusuar në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social si në zonën urbane po ashtu dhe atë rurale, mbështetjen dhe zhvillimin e mëtejshëm në fushën e arsimit, turizmit, trashëgimisë dhe kulturës nëpërmjet ndërmarrjes së aktiviteteve dhe projekteve të ndryshme. Vazhdon të mbetet në objektivat kryesore rritja e cilësisë dhe ofrimi në kohë i shërbimeve të ndryshme ndaj qytetarëve. Detajimi i fondeve për vitin 2022 është realizuar sipas programeve buxhetore ku janë mbajtur parasysh objektivat, qëllimet, produktet dhe përfituesit për të arritur një efektivitet dhe efikasitet sa më të lartë në përdorimin e fondeve të akorduara.

2. KUADRI LIGJOR

Raporti i konsoliduar i zbatimit të buxhetit të vitit 2022 është në zbatim të ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” nenit 51 “Raporti vjetor i konsoliduar i zbatimit të buxhetit vendor”, ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr.9936 datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, udhëzimit nr. 9 datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, udhëzimit nr. 22 datë 30.7.2018 “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të NJQV”, udhëzimit plotësues nr.1 datë 10.01.2022 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022", VKB nr. 147 datë 22.12.2021 “Mbi miratimin e buxhetit vjetor 2022 të Bashkisë Korçë”, VKB nr.6 datë 27.1.2022 “Për rishqyrtimin e VKB nr.147 datë 22.01.2021 “Për miratimin e buxhetit vjetor të Bashkisë Korçë”, VKB nr. 21 datë 10.02.2022 “Për përdorimin e të ardhurave të trashëguara të vitit 2021 të Bashkisë, Institucioneve të Varësisë në buxhetin e vitit 2022, VKB nr.134 datë 22.08.2022 “Për miratimin e rritjes së planit të buxhetit të vitit 2022 për Bashkinë Korçë (grand nga M.SH.M.S për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve) në vlerën 19,999,008 lekë, si dhe miratimin e kontributit të bashkisë për projektin “Qendër inovacioni dhe kreativiteti multifunksionale” në vlerën 9,729,011 lekë, VKB nr.50 datë 31.03.2022 “Për miratimin e rritjes së planit të të ardhurave

dhe të shpenzimeve në buxhetin e vitit 2022”, VKB nr.127 datë 29.07.2022 “Për miratimin e rritjes së planit të buxhetit dhe përdorimin e grandit për objektin “Punime shtësë tek tregu i gjësë së gjallë” financuar nga AZHBR, si dhe VKB nr.146 datë 29.09.2022 “Për miratimin e rritjes së planit të buxhetit dhe përdorimin e fondit për rritjen e pagave për funksionimin e arsimit parashkollor në Ndërmarrjen e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Cerdhes.

3. ANALIZA E BUXHETIT E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE 2022

Buxheti i vitit 2022 për Bashkinë Korçë ka qenë në vlerën 2,138,790 lekë. Realizimi i burimeve të financimit ka qenë 1,801,643 lekë ose 84% në raport me planin vjetor. Realizimi i shpenzimeve ka qenë 1,607,320 lekë ose 75% në raport me planin vjetor.

Burimet e financimit të planifikuara për vitin 2022 së bashku me përdorimin e tyre, duke e krahasuar dhe me vitin 2021 paraqiten si më poshtë:

000/lekë

Nr.	Burimet e financimit	Burimet e disponueshme 2021	Burimet e financimit 2022	Burimet e disponueshme 2022	Përdorimi i burimeve 2022
1	Të ardhurat e trashëguara	135,673	191,202	191,202	87,278
2	Transferta e pakushtëzuar	453,082	462,077	463,898	456,543
3	Transferta e pakushtëzuar sektoriale	341,083	337,568	341,392	310,064
4	Të ardhurat nga taksat dhe tarifrat vendore + Institucionet e varësisë	744,020	1,062,056	751,456	705,080
5	Sponsorizime dhe të ardhura të tjera	1,559	8,436	8,940	5,713
6	Grand nga AZHBR		24,756	24,756	22,643
7	Grand nga M.SH.M.S		19,999	19,999	19,999
8	Projektet IPA		32,696		
	Total	1,675,417	2,138,790	1,801,643	1,607,320

Tabela 1: Burimet e financimit dhe përdorimi i tyre 2022

Siç shihet dhe nga tabela e mësipërme burimet e financimit të disponueshme kanë qenë në masën 84%. Përdorimi i burimeve kundrejt burimeve të disponueshme ka qenë në masën 89% dhe kundrejt planit në masën 75%.

Buxheti i vitit 2022 është realizuar në masën 75% kundrejt planit të buxhetit, ku:

Shpenzimet e personelit kanë një realizim prej 93%, shpenzimet korrente kanë një realizim prej 78% dhe shpenzimet për investime kanë një realizim prej 35%, kundrejt planit.

Nr.	Shpenzimet	Fakt 2021	Plan 2022	Fakt 2022	% e realizimit
1	Shpenzime personeli (600+601)	652,307	741,669	691,405	93%
2	Shpenzimet operative (602)	544,719	697,747	579,270	83%
3	Subvencione (603)	9,998	10,000	9,999	100%
4	Transferta tek organizata të ndryshme (604)	119,650	176,024	111,782	64%
5	Transferta tek individët (606)	6,043	31,706	24,558	77%
6	Fondi rezervë dhe fondi i kontigjencës (609)	0	20,000	0	0%
7	Shpenzime principali & interesi (651+166)	45,415	45,170	43,433	96%
8	Hartim projektesh dhe oponenca teknike (230)	183	28,262	2,506	9%
9	Shpenzime kapitale (231)	105,900	388,212	144,367	37%
	TOTAL	1,484,215	2,138,790	1,607,320	75%

Tabela 2 : Plani i shpenzimeve dhe realizimi i tyre 2022



Grafiku 1 : % e realizimit të shpenzimeve 2022

Gjatë vitit 2022 ka një rritje prej 8.3% të realizimit të buxhetit krahasuar me vitin 2021, një tregues i rëndësishëm në qëndrueshmërinë ekonomike të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe zhvillimit të projekteve investuese.

3.1 Analiza e detajuar e burimeve të financimit

- **Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave nga taksa dhe tarifa për vitin 2022**

Bashkia Korçë për periudhën 12 mujore të vitit 2022, paraqet një performancë pozitive në mbledhjen e të ardhurave krahasuar me vitet paraardhëse.

Për vitin 2022 objektivat kryesore kanë qenë:

- Rritja e pajtueshmërisë vullnetare
- Rritja e performancës së mbledhjes të të ardhurave duke ju përfruar parashikimeve aktuale
- Përmirësimi dhe sigurimi i shërbimeve më të mira për tatimpaguesit dhe përmirësimi i klimës së marëdhëniesve administratë – taksapagues
- Masat kundër informalitetit, ulja e borxhit tatimor dhe fokusi në mirë-administrim
- Ulja e kostove administrative për taksapaguesit
- Zbatim efikas i legjislacionit tatimor në fuqi
- Zgjerimi i bazës të taksapaguesve

Në arritjen e objektivave janë mbajtur në konsideratë:

- Përmirësimi i administrimit të mbledhjes së të ardhurave me efekte në rritjen e tyre.
- Efektet e paketës fiskale për vitin 2022 por dhe paketave të viteve paraardhëse.
- Forcimi i mbledhjes së taksave dhe transparenca
- Trajtimi i barabartë i taksapaguesve
- Bashkëpjesmarrja dhe bashkëbisedimi me grupet e interesit
- Shërbimi dhe asistenca sa më e mirë ndaj taksapaguesit

Gjatë vitit 2022 rëndësi e veçantë iu dha implementimit të procedurave të thjeshta, zgjerimit të bazës taksapaguese, rritjes së nivelit të arkëtimit nëpërmjet politikave lehtësuese, rritjes së frymës së konkurrencës së ndershme, thjeshtimit dhe standartizimit të procedurave, si dhe trajtimit të qytetarëve dhe bizneseve si partnerë të përbashkët të bashkisë. Objektivat kryesisht të fokusuar në lehtësimin dhe

shpërndarjen e drejtë të ngarkesës tatimore, kanë ndikuar në nxitjen e zhvillimit dhe zgjerimit të biznesit, duke ruajtur dhe madje duke induktuar me efikasitet rritjen e të ardhurave për zërat kryesorë që lidhen me biznesin. Gjithashtu dhënia e shërbimeve të përmirësuara dhe informimi i taksapaguesit nëpërmjet sporteleve tona në qendër apo dhe çdo njësi administrative, agjentit tatimor Ujësjiellës Kanalizime, sporteleve të Postës Shqiptare të shpërndara gjeografikisht në territorin e bashkisë pranë qytetarit, si dhe shtrirja e përshtatja e afateve të pagesave me qëllim lehtësimin e taksapaguesit, kanë ndikuar në përmirësimin e vazhdueshëm të klimës së biznesit dhe marrëdhënies me taksapaguesin.

Objektivat e përcaktuara që kanë ndikuar në përmirësimin e klimës së biznesit, janë mbështetja e disa llojeve të aktiviteteve të cilat kanë një numër të konsiderueshëm të punësuarish, aktivitetet të cilat krijojnë ambientet dedikuar fëmijëve, kategori të caktuara të OJF-ve, bizneset që regjistrohen dhe zhvillohen nga studentë, subjektet e artizanatit, investitorët e huaj, subjektet në fushën e ICT (teknologjisë së informacionit) apo dhe institucioneve arsimore private, lehtësimi kryesisht i bizneseve të vogla, mbështetja me tarifa zero për fermerët, tarifa minimale për tregjet dhe ambulancat, subjekteve që ushtrojnë aktivitet në hapësira publike etj. Politikat e ngjashme për gjendjen sa më pranë taksapaguesit nëpërmjet taksave dhe tarifave në harmoni me shërbimin që ofrohet, si psh: dhënia e lehtësive fiskale për shtresat familjare në nevojë, mundësia e arkëtimit në këste dhe pranë njësive administrative ku banojnë etj, janë zbatuar dhe kanë rezultuar të suksesshme jo vetëm për zbutjen e vështirësive ekonomike për shtresa të veçanta të familjeve dhe reduktimin e papunësisë, por edhe për vetë rritjen e arkëtimeve nga viti në vit. Këto politika të lehtësimit fiskal dhe incentivues, shoqëruar paralelisht me përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimit, kanë ndikuar pozitivisht edhe në objektivin për zgjerimin e bazës së taksapaguesve. Rritja e vazhdueshme e të ardhurave si nga biznesi, ashtu edhe nga taksapaguesi familjar vërteton efikasitetin e këtyre politikave, kundrejt rezultatit pozitiv që bashkia ka arritur në rritjen e bazës së taksapaguesve, si familjar, ashtu edhe atij biznes. Vëmendje e veçantë gjatë vitit 2022 i është kushtuar monitorimit të detajuar dhe implementimi i regjistrave të saktë elektronikë të kapaciteteve fiskale, duke përfshirë gjithë territorin e bashkisë. Për këtë arsye ju kushtua vëmendje e veçantë dhe mbështetje logjistike më tej strukturave e konstatimeve në vend të këtyre kapaciteteve, u ushtruan verifikime të vazhdueshme në të gjitha njësitë administrative, duke vijuar me formalizimin e të dhënave dhe dixhitalizimin e tyre, me efekt arritjen e rezultateve shumë të mira në pothuajse të gjithë zërat kryesorë të të ardhurave. Kujdes të veçantë gjatë vitit 2022 ju kushtua përmirësimin të mëtejshëm të sistemeve të kompjuterizuara, detajimit të raporteve, emetimit të statistikave, saktësisht dhe detajimit të të dhënave për bizneset, pronat, familjet etj. Sot është e mundur

hedhja në sistemin e taksave të gjobave të DKT dhe Policisë Bashkiake, taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet, llogaritja automatike e kamatvonesave, llogaritja e menjëhershme dhe emetimi i akt-marrëveshjeve pranë sporteleve tona për subjektet, gjenerimi në kohë i detyrimit për subjektet që shfytëzojnë hapsira publike, parkingjet, ambulancë etj. Vendosmëria e administratës për të luftuar evazionin dhe ekonominë informale, forcuar kapacitetet administruese, rritur performancën e burimeve njerëzore, kanë ndikuar në prirjen rritëse të të ardhurave. Nëse krahasojmë realizimin e vitit 2022 me vitet parardhëse vërejmë se nga viti në vit kemi një performancë pozitive të arkëtimit të të ardhurave ku në krahasim me vitin 2021 kemi arkëtuar 1% më shumë ose 4,947 (mijë) lekë më shumë, në krahasim me vitin 2020 kemi arkëtuar 32 % më shumë ose 178,639 (mijë) lekë më shumë dhe në krahasim me vitin 2019 kemi arkëtuar 13 % më shumë ose 83,526 (mijë) lekë më shumë.

Objektivi kryesor për realizimin e të ardhurave buxhetore të planifikuara në vitin 2022 është realizuar në masën 71 % ose 303,926 (mijë) lekë me pak se planifikimi buxhetor.

Ndër arsytet që ndikuan në këtë mosrealizim vlen të theksojmë:

- Situata e krizës ekonomike në të gjitha tregjet botërore e cila pati ndikim të ndjeshëm në vendin tonë, kryesisht tek subjektet tregëtare por më tepër në ekonominë familjare.
- Mungesa e likuiditetit e cila vuri në vështirësi dhe pamundësi si subjektet e biznesit ashtu dhe familjet të likujdonin detyrimet brenda vitit ushtrimor.
- Përditësimi i informacionit për kapacitetet sidomos në sipërfaqet e pasurive të paluajtëshme, taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet, përlllogaritja e detyrimeve edhe për periudhën parardhëse e cila vazhdoi të ndikojë në mosrealizim.
- Mos bashkërendimi midis institucioneve apo dhe drejtorive për përmbushjen e detyrave dhe arritjen e objektivave.

Pavarësisht këtij niveli të arkëtimit të të ardhurave kundrejt planit referuar arkëtimeve mujore gjatë vitit 2022, është siguruar njëtrajtshmëri në nivelet e të ardhurave mujore, duke garantuar kështu të ardhurat e nevojshme për ushtrimin e funksioneve të veta të bashkisë për gjithë periudhën e vitit buxhetor.

Referuar arkëtimeve mujore gjatë vitit 2022, është siguruar njëtrajtshmëri në nivelet e të ardhurave mujore, duke garantuar kështu të ardhurat e nevojshme për ushtrimin e funksioneve të veta të bashkisë për gjithë periudhën e vitit buxhetor. Të ardhurat e veta u realizuan nga administrata e bashkisë, Njësitë Administrative, Institucionet dhe agjentët tatimorë, institucionet shtetërore etj. Vijimi i performancës së punës dhe i procesit bashkëpunues, garanton më tej sigurimin e të ardhurave të veta buxhetore vjetore

për përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve që ofron bashkia ndaj qytetarëve të saj, duke realizuar objektivat madhorë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të të gjithë territorit të bashkisë.

Me vendimin nr. 50 Datë 31.03.2022 “Për një ndryshim në VKB nr 147 dt. 22/12/2021 “Mbi miratimin e buxhetit vjetor 2022 të Bashkisë Korçë, VKB nr. 6 datë 27/01/2022 “ Për rishqyrtimin e VKB nr.147 datë 22/01/2021 “ për miratimin e buxhetit vjetor 2022 të Bashkisë Korçë” pas propozimeve dhe vendimeve të këshilltarëve vendosi: Të miratojë rritjen e planit të të ardhurave në buxhetin e vitit 2022 sipas tarifave i në vlerën 1,752,000 lekë e detajuar si më poshtë:

/lekë	
Plani i të ardhurave	Vlera
Tarifë për vendin e shitjes për kafshët	1,032,000
Tarifë për hyrjen e mjeteve	384,000
Tarifë shërbimi brenda tregut	336,000
Total	1,752,000

Më poshtë po paraqesim tabelën e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore sipas ndarjes dhe grafikët ilustrues plan-fakt si dhe peshën specifike sipas përqindjes që zë çdo ndarje sipas llojit të taksave dhe tarifave:

Nr.	EMËRTIMI	Vlera për periudhën e raportimit (Fakt progresiv)	Vlera e Buxhetit vjetor (Plan)
I	Të ardhurat nga taksat dhe tarifave	734,136,911	1,038,063,124
1	Taksat vendore	293,346,694	495,357,192
a.	Taksa mbi pasurinë e paluajtshme :	155,137,330	269,318,371
	Taksa mbi ndërtesën	122,707,066	185,165,510
	<i>Taksë ndertese per familje</i>	<i>63,659,965</i>	<i>89,619,870</i>
	<i>Taksë ndertese per biznes</i>	<i>59,047,101</i>	<i>95,545,640</i>
	Taksa mbi truallin	12,042,427	24,269,491
	<i>Taksë ndertese per familje</i>	<i>842,352</i>	<i>4,294,474</i>
	<i>Taksë ndertese per biznes</i>	<i>11,200,075</i>	<i>19,975,017</i>
	Taksa mbi tokën bujqësore	20,387,837	59,883,370
b.	Tatim fitimi i thjeshtuar për biznesin e vogël	1,541,883	5,473,380
c.	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	104,224,382	146,000,000

d.	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet	16,782,885	60,425,066
c.	Taksa e fjetjes në hotel	7,737,460	6,500,000
e.	Taksa e tabelës	7,922,754	7,640,375
2	Të ardhura jotatimore	348,047,181	446,835,372
a.	Tarifat e shërbimeve publike:	240,380,369	326,787,920
	Tarifë pastrimi	160,014,535	198,227,000
	<i>Tarifë pastrimi për familje</i>	82,557,244	113,836,290
	<i>Tarifë pastrimi për biznes</i>	75,750,624	82,210,710
	<i>Tarifë pastrimi për institucione/ojf</i>	1,706,667	2,180,000
	Tarifë ndriçimi	35,004,372	45,020,170
	<i>Tarifë ndriçimi për familje</i>	16,020,428	23,421,271
	<i>Tarifë ndriçimi për biznes</i>	18,687,277	21,183,899
	<i>Tarifë ndriçimi për institucione/ojf</i>	296,667	415,000
	Tarifë gjelbërimi	23,210,914	28,767,070
	<i>Tarifë gjelbërimi për familje</i>	9,620,492	12,824,554
	<i>Tarifë gjelbërimi për biznes</i>	13,293,755	15,527,516
	<i>Tarifë gjelbërimi për institucione/ojf</i>	296,667	415,000
	Tarifë mirmbajtje varreza	13,149,366	18,301,350
	Tarifë vjetore e mirëmbajtjes së sistemit të ujitjes	9,001,182	36,472,330
b.	Tarifa administrative	10,526,771	6,898,000
c.	Të tjera jo tatimore	97,140,041	113,149,452
3	Taksa të ndara	92,743,036	95,870,560
a.	Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtëshme	20,402,161	26,605,945
b.	Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura	44,057,543	40,028,515
c.	Renta minerare	549,188	236,100
d.	Tatim mbi të ardhurat personale	24,932,778	24,000,000
e.	Të tjera	2,801,366	5,000,000

Në tabelën më lart, pika 2, nën ndarja: b) tarifa administrative më e detajuar përbëhet nga :

- ❖ Tarifë regjistrimi për leje transporti
- ❖ Tarifë vendore për shqyrtim leje zhvillimi
- ❖ Tarifë për leje ndërtimi
- ❖ Çertifikatë për mbrojtje nga zjarri
- ❖ Miratim projekti
- ❖ Tarifa administrative dhe rregullatore të NJ.Vendore
- ❖ Tarifë vendore për konfirmim hartash
- ❖ Tarifë vendore për çertifikatë përdorimi

Pika 2, nën ndarja : c) të tjera jo tatimore më e detajuar përbëhet nga :


- ❖ Tarifë për servitutën e kalimit në pronat publike
- ❖ Tarifë parkimi
- ❖ Tarifë mur perimetral
- ❖ Tarifë për zënie hapësire publike
- ❖ Tarifë për therrje bagëtie
- ❖ Tarifë për depozitimin e mjetëve inerte

- ❖ Të ardhura nga qira trualli, objekti dhe tokë bujqësore
- ❖ Të ardhura nga shërbimet e M.Z.SH
- ❖ Të ardhura nga marrje pylli me qira, nga shitja e drurëve, nga prodhimet medicinale dhe nga shitja e dokumentave të ankandit.
- ❖ Të ardhura nga gjobat
- ❖ Të ardhura nga qiratë banesa sociale, nga qira banesa në pronësi të Bashkisë, Enti i banesave
- ❖ Tarifë regjistrimi biznesi
- ❖ Kamatë vonesa
- ❖ Të ardhura sekondare(kthim page, klsh etj)
- ❖ Tarifë për leje të ndryshme D.K.T



Analiza e realizimit sipas kategorive

Pjesën më të madhe të të ardhurave e përbëjnë të ardhurat jo tatimore me 33.5 %, të ardhurat nga taksat vendore me 28.3 % dhe të ardhurat nga taksat e ndara me 8.9 % të totalit të realizuar përgjatë vitit 2022.



-Të detajuar sipas zërave specifike për çdo ndarje paraqesim tabelën më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Në %
A	Taksat vendore	28.3%
	Taksa mbi ndërtesën	11.8%
	Taksa mbi truallin	1.2%
	Taksa mbi tokën bujqësore	2.0%
	Tatim fitimi i thjeshtuar për biznesin e vogël	0.2%
	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	10.0%
	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet	1.6%
	Taksa e fjetjes në hotel	0.8%
	Taksa e tabelës	0.8%
B	Të ardhura jotatimore	33.5%
	Tarifë pastrimi	15.4%
	Tarifë ndriçimi	3.4%
	Tarifë gjelbërimi	2.2%
	Tarifë mirëmbajtje varreza	1.3%
	Tarifë vjetore e mirëmbajtjes së sistemit të ujitjes	0.9%
	Tarifa administrative	1.0%

	Të tjera jo tatimore	9.4%
C	Taksa të ndara	8.9%
	Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme	2.0%
	Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura	4.2%
	Renta minerare	0.1%
	Tatim mbi të ardhurat personale	2.4%
	Të tjera	0.3%
	Totali A+B+C	70.7%

Të ardhurat për këto zëra në nivel dhe përqindje janë realizuar:

Bazuar në kapacitetet e detajuara në planifikimin buxhetor i cili u miratua me vendimin nr 147 dt. 22.12.2021. Gjithashtu dhe në ndryshimet e pësuar gjatë vitit 2022, (periudha Janar- 31 Dhjetor) ku sipas të dhënave të shkëmbyera me QKB, atyre të ngarkuara në sistem nga veprimet e kryera nga DRT-Korçë për tatimpaguesit që regjistrohen nga ana e tyre dhe familjeve të regjistruara rishtazi në Z. GJ.C.V - Bashkia Korçë rezulton se:

- Numri i subjekteve të regjistruara periudha Janar - 31 Dhjetor, sipas të dhënave të nxjerra nga raportet e sistemit kompjuterik, rezulton: 414 tatimpagues gjithsej.
- Numri i subjekteve që kanë aplikuar për ç’regjistrim periudha Janar - 31 Dhjetor, sipas të dhënave të nxjerra nga raportet e sistemit kompjuterik, rezulton: 254 subjekte gjithsej.
- Numri i subjekteve të cilat kanë kaluar me status pasiv periudha Janar - 31 Dhjetor, sipas të dhënave të nxjerra nga raportet e sistemit kompjuterik, rezulton: 172 tatimpagues gjithsej.
- Numri i familjeve të regjistruara të cilat kanë krijuar një ekonomi familjare të shkëputur nga familja bazë për periudhën Janar - 31 Dhjetor, sipas të dhënave të nxjerra nga raportet e sistemit kompjuterik, rezulton: 509 familje gjithsej.
- Numri i subjekteve të cilat kanë ndryshuar përgjegjësitë tatimore (kalim nga subjekte të biznesit të vogël në subjekte të biznesit të madh) periudha Janar - 31 Dhjetor, sipas të dhënave të nxjerra nga raportet e sistemit kompjuterik, rezulton: 93 tatimpagues gjithsej.

Realizimi i funksionit të regjistrimit të subjekteve dhe familjeve të reja, është kryer nëpërmjet: - Regjistrimeve në QKB nëpërmjet regjistrimeve të bizneseve të reja dhe mbikqyrjes së regjistrimit të

tatimpaguesve të kategorisë OJF-ve, Ambulante që kryet nga Drejtoria Rajonale Korçë si dhe regjistrimit të familjeve në Z.GJ.C.V- Bashkia Korçë .

o *Gjatë vitit 2022, (për periudhën Janar- Dhjetor) sipas të dhënave që disponojmë janë dërguar:*

-3,125 njoftim vlerësime tatimore për subjektet

-2,615 njoftim vlerësime tatimore për familjarë të cilët nuk kanë një kontratë furnizimi me ujë të pijshëm

- 93 njoftime për ndryshimin e përgjegjësisë tatimore (informacion i marrë nga DRT Korçë)

- 486 njoftim vlerësimi tatimor për subjektet e reja bazuar në informacionin e Q.K.B

-2,170 njoftime të përsëritura

- 225 njoftim dhe kërkesë për pagesë (subjektet dhe familjarët të cilët nuk kaluan për ndjekje të mbledhjes me forcë të detyrimeve)

-5,780 njoftime për përditësimin e të dhënave për pasuritë e paluajtëshme

-1745 njoftim vlerësime tatimore për pasuritë e paluajtëshme

-1869 urdhëra për vendosjen e bllokimit të llogarive bankare

- 74 urdhëra për vendosjen e barrës hipotekore

- 18 urdhëra për ekzekutim bankar për llogaritë e bllokuara të subjekteve dhe familjeve debitore

- 54 marëveshje bashkëpunimi janë lidhur për pagesë me këste të detyrimeve tatimore për subjekte biznesi

- 27 marëveshje bashkëpunimi janë lidhur për pagesë me këste të detyrimeve tatimore për familjarë


Taksat dhe tarifat që ndikojnë më shumë dhe mbajnë peshë kryesore në realizimin e të ardhurave janë:

- **tarifa e pastrimit** e cila ka peshën kryesore me **15.4 %** të të ardhurave të realizuara
- **taksa mbi pasuritë e paluajtëshme** (ndërtesë, truall, tokë bujqësore) e cila zë rreth **15 %** të të ardhurave të realizuara
- **tarifat e ndriçimit, gjelbërimit, mirëmbajtjes së varrezave publike dhe mirëmbajtjes së sistemit ujitës** të cilat zënë **7.8 %** të të ardhurave të realizuara

- **taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja dhe legalizimet** të cilat zënë **11.6 %** të të ardhurave të realizuara
- **taksa e regjistrimit të përvitshëm të automjeteve** e cila zë **4.2 %** të të ardhurave të realizuara

Fluksi monetar mujor i të ardhurave të veta, viti 2022


Falë fokusimit për taksim dhe tarifim të ndershëm, uljes së informalitetit, krijimit të kushteve të barabarta në treg, incentivave fiskale, zgjerimit të vazhdueshëm të bazës taksapaguese, evidentimit të kapaciteteve reale, ndjekjes së hapave ligjorë ndaj subjekteve dhe familjeve debitore, etj, të ardhurat kanë ruajtur një nivel relativisht konstant të arkëtimeve, duke siguruar kështu plotësimin buxhetor dhe likuiditetin e nevojshëm financiar në ushtrimin e funksioneve të veta të Bashkisë.



Siç duket dhe nga ilustrimi krahasues i paraqitur, duke ju referuar arkëtimeve mujore të vitit 2022, periudha me nivelin më të lartë të arkëtimeve ka qenë muaji Mars, Prill dhe Maj, periudhë kjo që përkon me afatin e pagesës për taksat dhe tarifatat lokale kryesisht nga subjektet e biznesit. Gjithashtu periudhë tjetër që bie në sy për nivel relativisht të lartë gjatë vitit 2022 krahasuar me vitin 2021 është dhe periudha e fundit e vitit konkretisht muajt Tetor dhe Dhjetor si efekt i njoftimeve të përsëritura dhe masave shtrënguese.

Realizimi i të ardhurave për vitin 2022 krahasuar me vitet e kaluara

Vitet	Realizim 2019	Realizim 2020	Realizim 2021	Realizim 2022
Të ardhurat për periudhën	650,610,418	555,498,333	729,159,774	734,136,911



Të ardhurat nga burimet e veta vendore për vitin 2022 arritën vlerën 734,137 mijë lekë. Duke marrë për bazë krahasimi 3 vite të periudhës paraardhëse na rezultojnë që viti 2022 të jetë viti me të ardhurat më të larta, konkretisht:

- Krahasuar me vitin 2019 rezultojnë me një diferencë prej 83,527 mijë lekë më shumë.
- Krahasuar me vitin 2020 rezultojnë me një diferencë prej 178,639 mijë lekë më shumë.
- Krahasuar me vitin 2021 rezultojnë me një diferencë prej 4,977 mijë lekë më shumë. (Theksojmë se viti 2020 pavarësisht se ka diferencën më të madhe krahasuar me 2022 nuk mund të merret si vit bazë krahasues për vetë situatën pandemike që e shoqëroi komplet vitin 2020)

Rritja e të ardhurave ka ardhur si efekt edhe i procedurave të verifikimit të kapaciteteve, përditësimit të të dhënave kryesisht për pasuritë e paluajtëshme, të ndjekjes së detyrimeve, bashkërendimit të punës ndërmjet Njësive Administrative, Agjentëve tatimore. Zgjerimi i bazës taksapaguese dhe rritja e arkëtimit ka ardhur si rezultat i verifikimeve të kapaciteteve dhe krijimit dhe formalizimit të bazës së të

dhënave, i kontakteve konstante në terren me subjektet dhe familjarët, nxitjes së vazhdueshme të debitorëve, si dhe i politikave lehtësuese, nxitëse e sensibilizuese të Bashkisë.

Tabela më poshtë paraqet planifikimin dhe realizimin e taksave dhe tarifave për vitin 2022 si dhe realizimin për periudhën paraardhëse 2019-2021.

Nr.	EMËRTIMI	Realizim 2019	Realizim 2020	Realizim 2021	Realizim 2022	Planifikim 2022	Në %
A	TË ARDHURA NGA TAKSAT VENDORE	242,295,295	185,557,657	307,550,109	293,346,695	495,357,192	59%
1	TAKSË MBI NDËRTESEN	96,209,399	93,163,646	114,846,019	122,707,067	185,165,510	66%
2	TAKSË MBI TRUALLIN	8,109,107	8,593,312	12,601,210	12,042,427	24,269,491	50%
3	TATIM MBI TOKËN BUJQËSORE	17,871,801	18,175,238	20,386,785	20,387,837	59,883,370	34%
4	TATIMI I THJESHTUAR MBI FITIMIN PËR BIZNESIN E VOGËL	5,555,848	5,252,764	6,174,696	1,541,883	5,473,380	28%
5	TAKSË NDIK.INFRAST. NGA NDËRTIMET E REJA	87,219,242	44,228,451	134,234,446	104,224,382	146,000,000	71%
6	TAKSË NDIK.INFRAST.NGA LEGALIZIMET	13,435,258	4,759,866	5,429,441	16,782,885	60,425,066	28%
7	TAKSË HOTELI	5,754,310	3,943,070	5,956,660	7,737,460	6,500,000	119%
8	TAKSË TABELE	8,140,330	7,441,310	7,920,852	7,922,754	7,640,375	104%
B	TË ARDHURA JO TATIMORE	341,921,830	310,639,196	332,345,109	348,047,180	446,835,372	78%
1	TARIFË PASTRIMI	158,711,065	148,508,366	160,894,253	160,014,535	198,227,000	81%
2	TARIFË NDRIÇIMI	35,295,758	32,906,154	35,364,905	35,004,372	45,020,170	78%
3	TARIFË GJELBËRIMI	23,404,849	21,733,830	23,731,605	23,210,914	28,767,070	81%
4	TARIFË MIRËMBAJTJE VARREZA	12,948,926	11,969,607	12,809,101	13,149,366	18,301,350	72%
5	TARIFË PËR ZENIE HAPESIRE PUBLIKE	21,024,032	13,028,689	20,993,471	21,243,712	28,530,019	74%
6	TARIFË REGJISTRIMI PËR LEJE TRANSPORTI	1,605,680	945,430	1,105,340	976,365	1,070,000	91%
7	TARIFË MUR PERIMETRAL	1,092,020	650,320	1,458,255	726,138	1,500,000	48%
8	TARIFË PARKIMI	18,707,966	13,915,718	20,566,853	19,396,160	21,548,520	90%
9	TË ARDHURA TË TJERA (vertetime, çertifikata etj.)	13,538,345	26,697,759	10,233,162	12,234,144	5,945,000	206%
10	ÇERTIFIKATË PËR MBROJTJEN NGA ZJARRI	1,517,600	415,000	523,250	325,000	322,000	101%
11	MIRATIM PROJEKTI	562,450	375,500	595,000	850,000	460,000	185%
12	SHËRBIME ZJARRFIKSE NË OBJEKTE TË SIG.	0	0	0	0	10,000	0%
13	SHËRBIME ZJARRFIKSE NDAJ TE TRETEVE	0	0	0	0	40,000	0%

14	MARRJE ME QERA PYLLI (KULLOTA+TOKE BUJQESORE)	13,941,946	5,940,844	3,816,355	8,712,064	8,000,000	109%
15	TË ARDH.NGA SHITJA E DRUVE TË ZJARRIT	12,540,960	2,709,640	1,600,000	2,346,060	2,500,000	94%
16	VËRTETIME TRANSPORTI	78,000	81,000	66,000	48,000	51,000	94%
17	PRODHIME TË DYTA MEDICINALE	663,000	0	0	0	500,000	0%
18	SHITJE DOKUMENTA ANKANDI	4,000	2,000	0	0	3,000	0%
19	GJOBA POLICIA BASHKIAKE	1,540,500	911,000	688,000	311,000	2,200,000	14%
20	GJOBË PËR VONESË NË PAGESË	6,186,821	5,507,599	6,857,732	5,258,446	7,900,000	67%
21	GJOBA TË DREJT. SË KONTROLLIT TË TERRITORIT	340,500	140,000	75,000	15,000	100,000	15%
22	GJOBA INSPEKTORIATI I NDËRTIMIT	1,302,000	706,000	2,041,716	2,581,858	2,000,000	129%
23	GJOBA TË DREJTORISË SË TË ARDHURAVE	160,000	40,000	120,000	20,000	360,000	6%
24	QERA OBJEKTI + QERA TRUALLI + QERA TOKA BUJQESORE	5,175,093	7,338,834	8,860,957	8,549,473	20,132,390	42%
25	TARIFË VENDORE PËR SHQYRTIM LEJE ZHVILLIMI	510,000	405,000	555,000	520,000	450,000	116%
26	TARIFË PËR LEJE NDËRTIMI	190,000	220,500	340,000	271,000	280,000	97%
27	TARIFË PËR SERVITUTIN E KALIMIT NË PRONË PUBLIKE	508,116	828,072	618,740	680,870	1,195,523	57%
28	TË ARDH.NGA QERATË, BANESA SOCIALE	7,059,294	6,188,186	6,917,333	6,773,422	6,860,000	99%
29	QERA NGA BANESAT NË PRON.TË BASHKISË, ENTI BANESAVE	2,863,855	2,222,447	1,352,353	13,464,724	5,230,000	257%
30	KAMAT VONESA (QIRA OBJEKTI)	449,054	129,954	230,043	492,276	100,000	492%
31	TARIFË PËR DEPOZITIMIN E MBETJEVE INERTE	0	0	0	1,871,100	2,760,000	68%
32	TARIFË VJETORE E MIRËMBAJTJES SË SISTEMIT TË UJITJES	0	6,121,748	9,930,685	9,001,182	36,472,330	25%
C	TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA	66,393,293	59,301,479	89,264,556	92,743,036	95,870,560	97%
1	TATIM SHITJE PASURI E PALUAJTSHME	9,161,810	2,906,783	22,932,304	20,402,161	26,605,945	77%
2	TAKSË REGJISTRIMI E PËRVITSHME (AUTOMJETE)	41,140,294	38,618,245	43,262,884	44,057,543	40,028,515	110%

3	RENTA MINERARE	575,607	395,906	331,454	549,188	236,100	233%
4	DIVIDENTI NGA U.K.KO	15,515,582	661,319	647,175	2,801,366	5,000,000	56%
5	TË ARDHURA NGA TATIMI MBI TË ARDHURAT PERSONALE	0	16,719,226	22,090,739	24,932,778	24,000,000	104%
A+B+C	TOTALI	650,610,418	555,498,333	729,159,774	734,136,911	1,038,063,124	71%

TË ARDHURA NGA TAKSAT VENDORE

Të ardhurat nga taksat vendore janë planifikuar në vlerën 495,357,192 lekë dhe janë realizuar në vlerën 293,346,695 lekë ose 59 % e planifikimit. Planifikimi në këtë masë ka ardhur si pasojë e planifikimit real të sipërfaqeve të pasurive të paluajtëshme, debitorëve për vitet paraardhëse sipas kufirit ligjor, ecurisë së arkëtimit referuar periudhave paraardhëse dhe planifikimit nga drejtoritë e Bashkisë. Duke ju referuar treguesve të detajuar të të ardhurave nga taksat vendore, ulja në raport me një vit më parë është 5 % ose e shprehur në shifra 14,203,414 lekë më pak.

Të detajuara paraqiten si më poshtë:

TAKSË MBI NDËRTESEN

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2022	Realizimi 2022	Përqindja
1	Taksë mbi ndërtesën	185,165,510	122,707,066	66 %

Taksa mbi ndërtesën planifikohet dhe arkëtohet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Është taksa që ka kontribuar me 11.8 % të totalit të të ardhurave të realizuara gjatë vitit 2022.


Krahasuar me vitin e kaluar, ka pësuar rritje në nivelin e arkëtimit me 7 % më shumë ose 7,861,048 lekë. Niveli i arkëtimit ka pasur rritje këtë vit me 7,115,671 lekë më shumë nga ndërtesat për qëllime banimi dhe 745,377 lekë më shumë nga ndërtesat për qëllime biznesi, me një total prej 7,861,048 lekë më shumë se vitin e kaluar.

Për vitin 2022 është planifikuar në vlerën **185,165,510 lekë** dhe është realizuar në masën **66%** kundrejt planifikimit ose në vlerë **122,707,066 lekë** konkretisht nga :

- Nga 360 subjekte të biznesit të madh në vlerën 23,137,762 lekë, detyrime këto të vitit 2022 si dhe nga 65 subjekte të biznesit të madh debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për taksën e ndërtesës gjatë vitit 2022 në vlerën 3,135,919 lekë.
- Nga 1071 subjekte të biznesit të vogël në vlerën 10,569,342 lekë, detyrime këto të vitit 2022 si dhe nga 123 subjekte të biznesit të vogël debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për taksën e ndërtesës gjatë vitit 2022 në vlerën 1,896,671 lekë.
- Nga 2 organizata jo fitimprurëse në vlerën 18,060 lekë.
- Nga 725 pronarë ndërtesash të cilët ambientet e tyre jua kanë lëshuar me qira subjekteve të biznesit të madh apo të vogël në vlerën 11,413,294 lekë si dhe nga 292 pronarë ndërtesash debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për taksën e ndërtesës gjatë vitit 2022 në vlerën 8,876,053 lekë.
- Nga abonentët familjarë të cilët kanë kontratë me UKKO dhe kanë kyer pagesat për vitin 2022 në vlerën 31,423,874 lekë si dhe nga abonentët familjarë të cilët kanë kontratë me UKKO dhe kanë qenë debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për taksën e ndërtesës gjatë vitit 2022 në vlerën 8,349,107 lekë.
 - Nga abonentët familjarë të Njësite Administrative (Bulgarec, Drenovë, Mollaj, Voskop, Voskopojë dhe Vithkuq) të cilët kanë kontratë me UKKO dhe kanë kyer pagesat për vitin 2022 në vlerën 6,131,290 lekë si dhe nga abonentët familjarë të cilët kanë kontratë me UKKO dhe kanë qenë debitorë për vitet 2017-2021 por që kryen pagesën për taksën e ndërtesës gjatë vitit 2022 në vlerën 1,888,707 lekë.
 - Nga familjarët rezidentë efektivë pa kontratë me UKKO të cilët janë paraqitur pranë nesh mbas njoftimeve të kryera nga ana jonë dhe kanë likujduar detyrimet e vitit 2022 por edhe detyrimet e viteve të mëparëshme në vlerën 9,199,421 lekë.
 - Nga familjarët rezidentë efektivë në Njësitë Administrative të Bashkisë Korçë që kanë likujduar detyrimet e vitit 2022 në vlerën 1,470,227 lekë si dhe nga familjarët rezidentë efektivë në Njësitë Administrative të Bashkisë Korçë që kanë qenë debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për taksën e ndërtesës gjatë vitit 2022 në vlerën 5,197,339 lekë.

Detyrimi i taksës mbi ndërtesën për biznesin likujdohet bashkë me detyrimet e tjera vjetore, ndërsa detyrimi për familjet llogaritet dhe likujdohet çdo muaj së bashku me faturën e shërbimit të furnizimit me ujë në UKKO, në cilësinë e agjentit tatimor.

Realizimet e mësipërme sipas % që këto arkëtime zenë në realizimin total të taksës së ndërtesës po i ilustruam grafikisht :



TAKSË MBI TRUALLIN

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2022	Realizimi 2022	Përqindja
2	Taksë mbi truallin	24,269,491	12,042,427	50 %

Taksa mbi truallin planifikohet dhe arkëtohet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.


Është taksa që ka kontribuar më 1.16 % të totalit të të ardhurave të realizuara gjatë vitit 2022. Krahasuar me vitin e kaluar, ka pësuar rënie në nivelin e arkëtimit me 4 % më pak ose 558,783 lekë. Niveli i arkëtimit ka pasur rënie këtë vit me 327,045 lekë më pak nga truall për qëllim banimi nga individë dhe 231,738 lekë më pak truall për qëllime biznesi, me një total prej 558,783 lekë më pak se vitin e kaluar.

Taksa mbi truallin për vitin 2022 është planifikuar në vlerën **24,269,471 lekë** dhe është realizuar në masën **50 %** kundrejt planifikimit ose në vlerë **12,042,427 lekë**. Taksa mbi truallin përfshin kategoritë e truallit për biznes dhe truallit për banim. Kjo taksë është arkëtuar në këtë nivel :

- Nga 161 subjekte të biznesit të madh në vlerën 6,152,015 lekë, detyrime këto të vitit 2022 si dhe nga 14 subjekte të biznesit të madh debitorë por që kryen pagesën për taksën e truallit gjatë vitit 2022 në vlerën 1,172,479 lekë.
- Nga 94 subjekte të biznesit të vogël në vlerën 1,084,696 lekë, detyrime këto të vitit 2022 si dhe nga 22 subjekte të biznesit të vogël debitorë por që kryen pagesën për taksën e truallit gjatë vitit 2022 në vlerën 274,910 lekë.
- Nga poseduesit e truallit për biznes dhe për banim në territorin e Bashkisë Korçë në vlerën 2,515,975 lekë.
- Nga familjarët rezidentë efektivë në Njësitë Administrative të Bashkisë Korçë kanë likujduar detyrimet e vitit 2022 në vlerën 394,328 lekë si dhe nga familjarët rezidentë efektivë në Njësitë Administrative të Bashkisë Korçë që kanë qenë debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për taksën e truallit gjatë vitit 2022 në vlerën 448,024 lekë.

Detyrimi i taksës mbi truallin për biznesin likujdohet bashkë me detyrimet e tjera vjetore, ndërsa detyrimi për familjet llogaritet dhe likujdohet çdo muaj së bashku me faturën e shërbimit të furnizimit me ujë në UKKO, në cilësinë e agjentit tatimor.

Realizimet e mësipërme sipas % që këto arkëtime zenë në realizimin total të taksës mbi truallin po i ilustron grafikisht :



TAKSË MBI TOKËN BUJQËSORE

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2022	Realizimi 2022	Përqindja
3	Taksë mbi tokën bujqësore	59,883,370	20,387,837	34%

Taksa mbi tokën bujqësore planifikohet dhe arkëtohet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Është taksa që ka kontribuar me 1.96 % të totalit të të ardhurave të realizuara gjatë vitit 2022. Taksa mbi tokën bujqësore për vitin 2022 është planifikuar **59,883,370 lekë** dhe është realizuar në masën **34 %** kundrejt planifikimit ose në vlerën **20,387,837 lekë**. Kjo shumë është arkëtuar nga poseduesit e tokës bujqësore në Bashkinë Korçë që kryen pagesën për detyrimin e vitit 2022 në vlerën 9,770,697 lekë dhe nga debitorët e viteve paraardhëse të cilët kryen pagesën gjatë vitit 2021 në vlerën 10,617,140 lekë.

Vlera prej 10,617,140 lekë detyrime këto prej viteve të mëparëshme është mundur të arkëtohet si rezultat i punës në terren, dërgimit të 7,814 njoftime për pagesë për poseduesit e tokës bujqësore (3,110 njoftime në Njësinë Administrative Bulgarec, 1,120 njoftime në Njësinë Administrative Drenovë, 1,983 njoftime në Njësinë Administrative Mollaj, 692 njoftime në Njësinë Administrative Voskop, 469 njoftime në Njësinë Administrative Voskopojë, 440 njoftime në Njësinë Administrative Vithkuq).

Kjo taksë ka një mosrealizim prej 39,495,533 lekë kundrejt planifikimit të vitit 2022.

E kemi ritheksuar çdo vit që taksa mbi tokën bujqësore është taksa që atakohet më shumë nga ana e taksapaguesve pasi shumica e tyre kundërshtojnë faturat të cilat kanë të përfshira dhe detyrimet debitore.

Realizimi prej 20,387,837 lekë është arkëtuar i detajuar si më poshtë:

- Njësia Administrative Bulgarec ka mundur të arkëtojë gjatë vitit 2022 vlerën prej 2,165,577 lekë detyrim i vitit korent 2022 dhe vlerën prej 3,722,136 lekë detyrim ky për periudhën paraardhëse.
- Njësia Administrative Drenovë ka mundur të arkëtojë gjatë vitit 2022 vlerën prej 1,640,524 lekë detyrim i vitit korent 2022 dhe vlerën prej 1,655,760 lekë detyrim ky për periudhën paraardhëse.
- Njësia Administrative Mollaj ka mundur të arkëtojë gjatë vitit 2022 vlerën prej 1,808,746 lekë detyrim i vitit korent 2022 dhe vlerën prej 1,550,991 lekë detyrim ky për periudhën paraardhëse.

- Njësia Administrative Voskop ka mundur të arkëtojë gjatë vitit 2022 vlerën prej 2,092,269 lekë detyrim i vitit korent 2022 dhe vlerën prej 1,987,572 lekë detyrim ky për periudhën paraardhëse.
- Njësia Administrative Voskopojë ka mundur të arkëtojë gjatë vitit 2022 vlerën prej 296,532 lekë detyrim i vitit korent 2022 dhe vlerën prej 715,266 lekë detyrim ky për periudhën paraardhëse.
- Njësia Administrative Vithkuq ka mundur të arkëtojë gjatë vitit 2022 vlerën prej 421,213 lekë detyrim i vitit korent 2022 dhe vlerën prej 600,079 lekë detyrim ky për periudhën paraardhëse.
- Njësia Administrative Lekas ka mundur të arkëtojë gjatë vitit 2022 vlerën prej 79,909 lekë detyrim i vitit korent 2022 dhe për periudhën paraardhëse.
- Njësia Administrative Korçë ka mundur të arkëtojë gjatë vitit 2022 vlerën prej 1,265,927 lekë detyrim i vitit korent 2022 dhe vlerën prej 385,336 lekë detyrim ky për periudhën paraardhëse.

TATIMI I THJESHTUAR MBI FITIMIN PËR BIZNESIN E VOGËL

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2022	Realizimi 2022	Përqindja
4	Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël	5,473,380	1,541,883	28 %

Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël administrohet, pas miratimit të ndryshimeve ligjore sipas ligjit 142/2015 dt 17.12.2015, “Për disa ndryshime dhe shtesa me ligjin 9632, datë 30/08/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, arkëtohet nga bizneset e vogla, dhe më pas i transferohet Bashkisë nga Drejtoria Rajonale Tatimore, në rolin e agjentit tatimor.

Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël në buxhetin e vitit 2022 është planifikuar në vlerën **5,473,380 lekë** dhe është realizuar në masën **28 %** kundrejt planifikimit ose në vlerë **1,541,883 lekë**. Ky realizim vjen si rezultat i zbatimit të masave shtrënguese sipas legjislacionit në fuqi për arkëtimin e detyrimeve paraardhëse si taksë vendore të pa paguara nga 7 subjekte debitore në vlerën 424,293 lekë dhe nga arkëtimi i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin në vlerën 1,117,590 lekë konkretisht nga :

- 15 subjekte për vitin 2014 me vlerë 129,707 lekë
- 12 subjekte për vitin 2015 me vlerë 177,423 lekë
- 9 subjekte për vitin 2016 me vlerë 45,000 lekë
- 7 subjekte për vitin 2017 me vlerë 35,000 lekë

- 5 subjekte për vitin 2018 me vlerë 25,000 lekë
- 16 subjekte për vitin 2019 me vlerë 359,884 lekë
- 16 subjekte për vitin 2020 me vlerë 155,693 lekë
- 34 subjekte për vitin 2021 me vlerë 189,883 lekë të cilat janë derdhur për llogari të Bashkisë Korçë nga DRT Korçë si tatim i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël ku kjo e fundit bazuar në legjislacionin aktual në fuqi është në rolin e agjentit tatimor.

TAKSË E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2022	Realizimi 2022	Përqindja
5	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	146,000,000	104,224,382	71%

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja planifikohet dhe arkëtohet nga Drejtoria Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit.

Është taksa që ka kontribuar me 10 % të totalit të të ardhurave të realizuara gjatë vitit 2022.

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja për vitin 2022 është planifikuar në vlerën **146,000,000 lekë** dhe është realizuar në masën **71 %** kundrejt planifikimit ose në vlerën **104,224,382 lekë**.

Kjo taksë është realizuar si pasojë e dhënies së 110 lejavave dhe arkëtimit të tyre konkretisht nga:

- Leje me destinacion banimi në vlerën 48,460,483 lekë, për 89 objekte
- Leje me destinacion banim + ekonomike në vlerën 42,036,286 lekë, për 5 objekte
- Leje me destinacion ekonomik në vlerën 13,726,989 lekë, për 16 objekte

TAKSË E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA LEGALIZIMET

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2022	Realizimi 2022	Përqindja
6	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet	60,425,066	16,782,885	28 %

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet planifikohet dhe arkëtohet nga Drejtoria Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit.

Është taksa që ka kontribuar me 1.62 % të totalit të të ardhurave të realizuara gjatë vitit 2022. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet për vitin 2022 është planifikuar në vlerën **60,425,066 lekë** dhe është realizuar në masën **28 %** kundrejt planifikimit ose në vlerën **16,782,885 lekë**. Krahasuar me vitin e kaluar, ka pësuar rritje në nivelin e arkëtimit me 209 % më shumë ose në vlerën 11,353,444 lekë. Kjo rritje vjen si pasojë e aplikimit të masave shtërnguese për individët apo subjektet që figuronin debitore për vitet e kaluara si dhe regjistrimit dhe gjenerimit të të dhënave në sistemin e taksave dhe tarifave vendore për detyrimet e vitit 2022

TAKSË E FJETJES NË HOTEL

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2022	Realizimi 2022	Përqindja
7	Taksa e fjetjes në hotel	6,500,000	7,737,460	119 %

Taksa e fjetjes në hotel planifikohet dhe arkëtohet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Është taksa që ka kontribuar më 0.7 % të totalit të të ardhurave të realizuara gjatë vitit 2022.

Taksë fjetje në hotel për vitin 2022 është planifikuar në vlerën **6,500,000 lekë** dhe është realizuar në masën **119 %** kundrejt planifikimit ose në vlerën **7,737,460 lekë**.

Nga kontrollat e ushtruara gjatë vitit 2022 janë mbajtur gjithsej 667 aktkonstatime ku janë verifikuar dhe kontrolluar regjistrat e fjetjes në lidhje me deklarimin e personave të akomoduar në çdo subjekt që ushtron aktivitet “Hoteleri/Bujtinë” ose ofron shërbimin e fjetjes kundrejt pagesës në territorin e Bashkisë Korçë.

Kjo taksë është arkëtuar në vlerën prej **7,737,460 lekë** nga:

- 112 subjekte që kanë deklaruar një numër akomoduesish prej 87,396 persona/shtretër në vlerën 6,117,730 lekë detyrime këto të vitit 2022 (pa përfshirë detyrimin e muajit dhjetor 2022 i cili deklarohet dhe paguhet në janar të vitit 2023 sipas afatit të miratuar në paketën fiskale).
- 72 subjekte që kanë deklaruar një numër akomoduesish prej 13,388 persona/shtretër në vlerën 937,160 lekë, detyrim ky i muajit dhjetor 2021 i cili deklarohet dhe paguhet në janar të vitit 2022 sipas afatit të miratuar në paketën fiskale.

Nga 25 subjekte debitorë të viteve të mëparëshme që e kryen pagesën gjatë vitit 2022 në vlerën 682,160 lekë.

TAKSË TABELË

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2022	Realizimi 2022	Përqindja
8	Taksë table	7,640,375	7,922,754	104%

Taksa e tabelës planifikohet nga Drejtoria e Kontrollit të Territorit dhe arkëtohet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Është taksa që ka kontribuar me 0.76 % të totalit të të ardhurave të realizuara gjatë vitit 2022.


Taksa e tabelës për qëllime identifikimi dhe reklamimi për vitin 2022 është planifikuar në vlerën **7,640,375 lekë** dhe është realizuar në masën **104 %** kundrejt planifikimit ose në vlerë **7,922,754 lekë**. Kjo taksë është realizuar nga :

- Nga 90 subjekte të cilat kanë vendosur tabelë për qëllime identifikimi dhe reklamimi në vlerën 7,679,692 dhe lekë.
- Nga 15 subjekte debitorë për vitet e mëparëshme që e kryen pagesën për taksën e tabelës për qëllime identifikimi dhe reklamimi gjatë vitit 2022 në vlerën 243,063 lekë.

Më poshtë po paraqesim tabelën dhe grafikun me peshën specifike që zë secila taksë vendore kundrejt totalit të realizimit për pjesën e taksave vendore për vitin 2022

Nr	Emërtimi	Në %
A	Taksat vendore	
1	Taksa mbi ndërtesën	42%
2	Taksa mbi truallin	4%
3	Taksa mbi tokën bujqësore	7%
4	Tatim fitimi i thjeshtuar për biznesin e vogël	1%
5	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	36%

6	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet	6%
7	Taksa e fjetjes në hotel	3%
8	Taksa e tabelës	3%



TË ARDHURA JO TATIMORE

Të ardhurat jo tatimore janë planifikuar në nivelin 446,835,372 lekë dhe janë realizuar në nivelin 348,047,180 lekë ose 78 % e planifikimit. Planifikimi në këtë masë ka ardhur si pasojë e planifikimit real të kapaciteteve, zgjerimit të bazës, debitorëve për vitet paraardhëse sipas kufirit ligjor, ecurisë së arkëtimeve referuar periudhave paraardhëse dhe planifikimit nga drejtoritë e Bashkisë. Duke ju referuar treguesve të detajuar të të ardhurave jo tatimore, rritja në raport me një vit më parë është 5 % ose e shprehur në shifra 15,702,071 lekë.

Të detajuara paraqiten si më poshtë:

TARIFË E PASTRIMIT

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2022	Realizimi 2022	Përqindja
1	Tarifë e Pastrimit	198,227,000	160,014,535	81 %

Tarifa e pastrimit planifikohet dhe arkëtohet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Është tarifa që ka kontribuar më shumë dhe ka mbajtur peshën kryesore në realizimin e të ardhurave me 15.4 % të totalit të të ardhurave të realizuara gjatë vitit 2022.

Tarifa e pastrimit për vitin 2022 është planifikuar në vlerën **198,227,000 lekë** dhe është realizuar në masën **81 %** kundrejt planifikimit ose në vlerë **160,014,535 lekë**. Krahasuar me vitin e kaluar, ka pësuar rënie në nivelin e arkëtimit me 1 % më pak ose 879,718 lekë. Niveli i arkëtimit ka pasur rritje këtë vit me 152,874 lekë më shumë nga tarifa e pastrimit për çdo familje dhe 1,032,592 lekë më pak tarifa e pastrimit nga subjektet tregëtare, me një total prej 879,718 lekë më pak se vitin e kaluar. Kjo shumë është arkëtuar :


- Nga 672 subjekte të biznesit të madh në vlerën 42,436,121 lekë, detyrime këto të vitit 2022 si dhe nga 84 subjekte të Biznesit të Madh debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e pastrimit gjatë vitit 2022 në vlerën 1,998,168 lekë.
- Nga 2436 subjekte të Biznesit të Vogël në vlerën 23,971,504 lekë, detyrime këto të vitit 2022 si dhe nga 303 subjekte të Biznesit të Vogël debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e pastrimit gjatë vitit 2021 në vlerën 2,459,831 lekë.
- Nga 98 subjekte ndërtuese që kanë paguar tarifën e pastrimit për çdo kantier ndërtimi pasi kanë tërhequr lejen e ndërtimit pranë Bashkisë Korçë, në vlerë 4,885,000 lekë detyrime këto të vitit 2022.
- Nga 71 institucione shtetërore dhe organizata jo fitimprurëse në vlerën 1,586,667 lekë detyrime këto të vitit 2022 si dhe nga 9 institucione shtetërore dhe organizata jo fitimprurëse debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e pastrimit gjatë vitit 2022 në vlerën 120,000 lekë.
- Nga abonentët familjarë të cilët kanë kontratë me UKKO dhe kanë kryer pagesat për vitin 2022 në vlerën 56,789,740 lekë si dhe nga abonentët familjarë të cilët kanë kontratë me UKKO që kanë qenë debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e pastrimit gjatë vitit 2022 në vlerën 14,170,607 lekë.
- Nga abonentët familjarë të Njësive Administrative (Bulgarec, Drenovë, Mollaj, Voskop, Voskopoje dhe Vithkuq) të cilët kanë kontratë me UKKO dhe kanë kryer pagesat për vitin 2022 në vlerën 5,940,935 lekë si dhe nga abonentët familjarë të cilët kanë kontratë me UKKO dhe kanë qenë

debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e pastrimit gjatë vitit 2022 në vlerën 1,479,780 lekë.

- Nga familjarët rezidentë efektivë pa kontratë me UKKO të cilët janë paraqitur pranë nesh mbas njoftimeve të kryera nga ana jonë dhe kanë likuajduar detyrimet e vitit 2022 në vlerën 590,086 lekë, nga abonentët familjarë rezidentë efektivë të cilët nuk kanë kontratë me UKKO që kanë qenë debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e pastrimit gjatë vitit 2022 në vlerën 1,176,789 lekë.
- Nga familjarët rezidentë efektivë në Njësitë Administrative të Bashkisë Korçë që kanë likuajduar detyrimet e vitit 2022 në vlerën 873,056 lekë si dhe nga familjarët rezidentë efektivë në Njësitë Administrative të Bashkisë Korçë që kanë qenë debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e pastrimit gjatë vitit 2022 në vlerën 1,536,251 lekë.

Detyrimi i tarifës së pastrimit për biznesin likuajdohet bashkë me detyrimet e tjera vjetore, ndërsa detyrimi për familjet llogaritet dhe likuajdohet çdo muaj së bashku me faturën e shërbimit të furnizimit me ujë në UKKO, në cilësinë e agjentit tatimor.

Realizimet e mësipërme sipas % që këto arkëtime zenë në realizimin total të tarifës së pastrimit po i ilustruam grafikisht :



TARIFË NDRICIMI

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2022	Realizimi 2022	Përqindja
2	Tarifë Ndrëçimi	45,020,170	35,004,372	78%

Tarifa e ndrëçimit planifikohet dhe arkëtohet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Është tarifa që ka kontribuar me 3.37 % të totalit të të ardhurave të realizuara gjatë vitit 2022.

Tarifa e ndrëçimit për vitin 2022 është planifikuar në vlerën **45,020,170 lekë** dhe është realizuar në masën **78%** kundrejt planifikimit ose në vlerë **35,004,372 lekë**. Krahasuar me vitin e kaluar, ka pësuar rënie në nivelin e arkëtimit me 1 % më pak ose 360,533 lekë. Niveli i arkëtimit ka pësuar rënie këtë vit me 722,684 lekë më pak nga tarifa e ndrëçimit për çdo familje dhe 362,151 lekë më shumë tarifa e ndrëçimit nga subjektet tregëtare, me një total prej 360,533 lekë më pak se vitin e kaluar. Kjo shumë është arkëtuar :


- Nga 634 subjekte të biznesit të madh në vlerën 6,579,343 lekë, detyrime këto të vitit 2022 si dhe nga 64 subjekte të biznesit të madh debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e ndrëçimit gjatë vitit 2022 në vlerën 363,616 lekë.
- Nga 2436 subjekte të biznesit të vogël në vlerën 10,396,782 lekë, detyrime këto të vitit 2022 si dhe nga 287 subjekte të biznesit të vogël debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e ndrëçimit gjatë vitit 2022 në vlerën 952,536 lekë.
- Nga 98 njësi ndërtimi për çdo kantier ndërtimi në vlerë 349,000 lekë detyrime këto të vitit 2022.
- Nga 71 institucione shtetërore dhe organizata jo fitimprurëse në vlerën 281,667 lekë detyrime këto të vitit 2022 si dhe nga 3 institucione shtetërore dhe organizata jo fitimprurëse debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e ndrëçimit gjatë vitit 2022 në vlerën 15,000 lekë.
- Nga abonentët familjarë të cilët kanë kontratë me UKKO dhe kanë kryer pagesat për vitin 2022 në vlerën 9,428,741 lekë si dhe nga abonentët familjarë të cilët kanë kontratë me UKKO që kanë qenë debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e ndrëçimit gjatë vitit 2022 në vlerën 2,749,362 lekë.
- Nga abonentët familjarë të Njësave Administrative (Bulgarec, Drenovë, Mollaj, Voskop, Voskopojë dhe Vithkuq) të cilët kanë kontratë me UKKO dhe kanë kryer pagesat për vitin 2022 në vlerën 1,998,081 lekë si dhe nga abonentët familjarë të cilët kanë kontratë me UKKO dhe kanë qenë

debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e ndriçimit gjatë vitit 2022 në vlerën 493,562 lekë.

- Nga familjarët rezidentë efektivë pa kontratë me UKKO të cilët janë paraqitur pranë nesh mbas njoftimeve të kryera nga ana jonë dhe kanë likujduar detyrimet e vitit 2022 në vlerën 113,692 lekë, nga familjarët rezidentë efektivë të cilët nuk kanë kontratë me UKKO, që kanë qenë debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e ndriçimit gjatë vitit 2022 në vlerën 351,912 lekë.
- Nga familjarët rezidentë efektivë në njësitë administrative të Bashkisë Korçë që kanë likujduar detyrimet e vitit 2022 në vlerën 301,393 lekë si dhe nga familjarët rezidentë efektivë në Njësitë Administrative të Bashkisë Korçë që kanë qenë debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e ndriçimit gjatë vitit 2022 në vlerën 629,685 lekë.

Detyrimi i tarifës së ndriçimit për biznesin likujdohet bashkë me detyrimet e tjera vjetore, ndërsa detyrimi për familjet llogaritet dhe likujdohet çdo muaj së bashku me faturën e shërbimit të furnizimit me ujë në UKKO, në cilësinë e agjentit tatimor.

Realizimet e mësipërme sipas % që këto arkëtime zenë në realizimin total të tarifës së ndriçimit po i ilustruam grafikisht :



TARIFË GJELBËRIMI

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2022	Realizimi 2022	Përqindja
3	Tarifë Gjëlberimi	28,767,070	23,210,914	81%

Tarifa e gjëlberimit planifikohet dhe arkëtohet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Është tarifa që ka kontribuar me 2.24 % të totalit të të ardhurave të realizuara gjatë vitit 2022.

Tarifa e gjëlberimit për vitin 2022 është planifikuar në vlerën **28,767,070 lekë** dhe është realizuar në masën **81 %** kundrejt planifikimit ose në vlerë **23,210,914 lekë**. Krahasuar me vitin e kaluar, ka pësuar rënie në nivelin e arkëtimit me 2 % më pak ose 520,691 lekë. Niveli i arkëtimit ka pasur rënie këtë vit me 135,965 lekë më pak nga tarifa e gjëlberimit për çdo familje dhe 384,726 lekë më pak tarifa e gjëlberimit nga subjektet tregëtare, me një total prej 520,691 lekë më pak se vitin e kaluar.


Kjo shumë është arkëtuar:

- Nga 629 subjekte të biznesit të madh në vlerën 4,046,295 lekë, detyrime këto të vitit 2022 si dhe nga 57 subjekte të biznesit të madh debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e gjëlberimit gjatë vitit 2022 në vlerën 200,352 lekë.
- Nga 2162 subjekte të biznesit të vogël në vlerën 7,896,755 lekë, detyrime këto të vitit 2022 si dhe nga 216 subjekte të biznesit të vogël debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e gjëlberimit gjatë vitit 2022 në vlerën 649,353 lekë.
- Nga 98 njësi ndërtimi për çdo kantier ndërtimi në vlerë 501,000 lekë detyrime këto të vitit 2022.
- Nga 71 institucione shtetërore dhe organizata jo fitimprurëse në vlerën 281,667 lekë detyrime këto të vitit 2022 si dhe nga 3 institucione shtetërore dhe organizata jo fitimprurëse debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e gjëlberimit gjatë vitit 2022 në vlerën 15,000 lekë.
- Nga abonentët familjarë të cilët kanë kontratë me UKKO dhe kanë kryer pagesat për vitin 2022 në vlerën 7,383,176 lekë si dhe nga abonentët familjarë të cilët kanë kontratë me UKKO që kanë qenë debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e gjëlberimit gjatë vitit 2022 në vlerën 1,963,729 lekë.
- Nga familjarët rezidentë efektivë pa kontratë me UKKO të cilët janë paraqitur pranë nesh mbas njoftimeve të kryera nga ana jonë dhe kanë likujtuar detyrimet e vitit 2022 në vlerën 74,773 lekë, nga familjarët rezidentë efektivë të cilët nuk kanë kontratë me UKKO, që kanë qenë debitorë për

vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e gjelbërimit gjatë vitit 2022 në vlerën 198,814 lekë.

Detyrimi i tarifës së gjelbërimit për biznesin likujdohet bashkë me detyrimet e tjera vjetore, ndërsa detyrimi për familjet llogaritet dhe likujdohet çdo muaj së bashku me faturën e shërbimit të furnizimit me ujë në UKKO, në cilësinë e agjentit tatimor.

Realizimet e mësipërme sipas % që këto arkëtime zenë në realizimin total të tarifës së gjelbërimit po i ilustruam grafikisht :



TARIFË MIRËMBAJTJE VARREZA PUBLIKE

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2022	Realizimi 2022	Përqindja
4	Tarifë mirëmbajtje varreza publike	18,301,350	13,149,366	72 %

Tarifa për mirëmbajtjen e varrezave publike planifikohet dhe arkëtohet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Është tarifa që ka kontribuar me 1.3 % të totalit të të ardhurave të realizuara gjatë vitit 2022.

Tarifa për mirëmbajtjen e varrezave publike për vitin 2022 është planifikuar në vlerën **18,301,350 lekë** dhe është realizuar në masën **72 %** kundrejt planifikimit ose në vlerë **13,149,366 lekë**. Krahasuar me vitin e kaluar, ka pësuar rritje në nivelin e arkëtimit për këtë tarifë me 3 % më shumë ose 340,265 lekë.

Kjo shumë është arkëtuar :

- Nga abonentët familjarë të cilët kanë kontratë me UKKO dhe kanë kyer pagesat për vitin 2022 në vlerën 7,581,303 lekë si dhe nga abonentët familjarë të cilët kanë kontratë me UKKO që kanë qenë debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e varrezës gjatë vitit 2022 në vlerën 1,842,541 lekë.
- Nga abonentët familjarë të Njësive Administrative (Bulgarec, Drenovë, Mollaj, Voskop, Voskopoje dhe Vithkuq) të cilët kanë kontratë me UKKO dhe kanë kyer pagesat për vitin 2022 në vlerën 1,954,108 lekë si dhe nga abonentët familjarë të Njësive Administrative të cilët ishin debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën në vitin 2022 në vlerën 493,561 lekë.
- Nga familjarët rezidentë efektivë pa kontratë me UKKO të cilët janë paraqitur pranë nesh mbas njoftimeve të kryera nga ana jonë dhe kanë likujduar detyrimet e vitit 2022 në vlerën 83,023 lekë, nga familjarët rezidentë efektivë të cilët nuk kanë kontratë me UKKO, që kanë qenë debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e varrezës gjatë vitit 2022 në vlerën 251,182 lekë.
- Nga familjarët rezidentë efektivë në njësitë administrative të Bashkisë Korçë në vlerën 287,083 lekë si dhe nga familjarët rezidentë efektivë në njësitë administrative të Bashkisë Korçë të cilët ishin debitorë për vitet paraardhëse dhe kanë kryer pagesën për tarifën e varrezës gjatë vitit 2022 në vlerën 656,565 lekë.

TARIFË PËR ZËNIE TË HAPËSIRAVE PUBLIKE


Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2022	Realizimi 2022	Përqindja
5	Tarifë për zënien e hapësirave publike	28,530,019	21,243,712	74 %

Tarifë për zënie hapësire publike planifikohet nga Drejtoria e Kontrollit të Territorit dhe arkëtohet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Tarifë për zënie hapësire publike për vitin 2022 është planifikuar në vlerën **28,530,019 lekë** dhe është realizuar në masën **74 %** ose në vlerë **21,243,712 lekë**. Krahasuar me vitin e kaluar, ka pësuar rritje në nivelin e arkëtimit për këtë tarifë me 1 % më shumë ose 250,241 lekë.

Më të detajuar po e paraqesim :

- Tek inkubatori i biznesit (ish U.M.B) dhe Markata e Shijes detyrim i vitit 2022 në vlerën 6,461,890 lekë dhe për vitet paraardhëse në vlerën 893,945 lekë.
- Hapësirë publike detyrim i vitit 2022 në vlerën 10,357,987 lekë dhe për vitet paraardhëse në vlerën 1,811,810 lekë.
- Ekspozim malli detyrim i vitit 2022 në vlerën 1,047,600 lekë dhe për vitet paraardhëse në vlerën 100,500 lekë.
- Tek tregu i gjësë së gjallë në vlerën 471,080 lekë.
- Promocione dhe panairë në vlerën 98,900 lekë



TARIFË REGJISTRIMI PËR LEJË TRANSPORTI

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2022	Realizimi 2022	Përqindja
6	Tarifë regjistrimi për lejë transporti	1,070,000	976,365	91%

Tarifë e regjistrimit për lejë transporti planifikohet dhe arkëtohet nga Drejtoria e Kontrollit të Territorit.

Tarifë regjistrimi leje transporti për vitin 2022 është planifikuar **1,070,000 lekë** dhe realizimi i saj deri në fund të vitit është realizuar në masën **91 %** ose në vlerë **976,365 lekë**. Realizimi i kësaj tarife vjen si rezultat i arkëtimeve të kryera nga :

1. Transport malli (licensim & çertifikim) në vlerën 103,890 lekë.
2. Transport udhëtarësh me taksi në vlerën 375,100 lekë.
3. Transport udhëtarësh me linjë qytetëse, rrethqytetëse dhe ndërqytetëse në vlerën 245,375 lekë.
4. Autorizime kamioni të tonazhit të rëndë në vlerën 237,000 lekë.
5. Agjensi transporti udhëtarësh në vlerën 15,000 lekë.

TARIFË MUR PERIMETRAL

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2022	Realizimi 2022	Përqindja
7	Tarifë mur perimetral	1,500,000	726,138	48%

Tarifë mur perimetral planifikohet dhe arkëtohet nga Drejtoria Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit.

Tarifë mur perimetral për vitin 2022 është planifikuar **1,500,000 lekë** dhe është realizuar në masën **48 %** ose në vlerë **726,138 lekë**. Kjo tarifë është realizuar si pasojë e dhënies së 136 lejave dhe arkëtimit të tyre konkretisht nga:

- Leje për destinacion banimi në vlerën 355,328 lekë, për 89 objekte
- Leje për destinacion banim+ekonomike në vlerën 257,100 lekë, për 5 objekte
- Leje për destinacion ekonomik në vlerën 113,710 lekë, për 16 objekte


TARIFË PARKIMI

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2022	Realizimi 2022	Përqindja
8	Tarifë Parkimi	21,548,520	19,396,160	90%

Tarifë parkimi planifikohet nga Drejtoria e Kontrollit të Territorit dhe arkëtohet pjesërisht nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe nga vetë strukturat e Drejtorisë së Kontrollit të Territorit.

Tarifë parkimi për vitin 2022 është planifikuar në vlerën **21,548,520 lekë** dhe është realizuar në masën **90 %** ose në vlerë **19,396,160 lekë**. Realizimi i kësaj tarife vjen si rezultat i arkëtimeve të kryera nga:

- Tarifa e parkimit të rezervuar për institucionet shtetërore apo subjektet private që kanë kryer pagesën për vitin 2022 në vlerën 4,651,560 lekë duke përfshirë këtu dhe detyrimet debitorë për vitet paraardhëse në vlerën 558,750 lekë.
- Tarifë parkimi me pagesë për rezidentë në vlerën 80,400 lekë.
- Tarifa e parkimit me pagesë (bileta) në vlerën 14,105,450 lekë.



TË ARDHURA TË TJERA, VËRTETIME, CERTIFIKATA

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2022	Realizimi 2022	Përqindja
9	Të ardhura të tjera, vërtetime, çertifikata etj.	5,945,000	12,234,144	206 %

Të ardhura të tjera ku përfshihen (tarifa shërbimi, vërtetime, çertifikata, leje ushtrimi aktiviteti, tarifë regjistrim biznesi, etj), për vitin 2022 është planifikuar në vlerën **5,945,000 lekë** dhe është realizuar në masën **206 %** ose në vlerën **12,234,144 lekë**.

Këtë realizim po e detajojmë sipas zërave :

- a) Tarifë regjistrim biznesi në vlerën 75,000 lekë (arkëtuar nga 4 subjekte debitorë)
- b) Kamatë vonesa në vlerën 120,703 lekë
- c) Tarifë administrative dhe rregullatore e njësisve vendore në vlerën 112,643 lekë
- d) Tarifë licence për shitje me pakicë të lëndëve djegëse apo leje për ushtrim aktiviteti në vlerën 4,930,000 lekë
- e) Të ardhura sekondare në vlerën 1,136,535 lekë
- f) Tarifë për dhënie në përdorim të tubacioneve nëntokësore në vlerën 18,600 lekë
- g) Tarifë vendore për lëshime vërtetimi në vlerën 382,100 lekë
- h) Tarifë vendore për konfirmime hartash në vlerën 2,350 lekë
- i) Tarifë vendore për çertifikata përdorimi në vlerën 1,686,486 lekë
- j) Të ardhura dividenti nga K.R.W.M 2021 në vlerën 3,257,727 lekë
- k) Të ardhura nga tenderat në vlerën 288,000 lekë
- l) Të ardhura nga shitje trualli në vlerën 224,000 lekë

CERTIFIKATË PËR MBROJTJEN NGA ZJARRI

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2022	Realizimi 2022	Përqindja
10	Çertifikatë për mbrojtjen nga zjarri	322,000	325,000	101 %

Çertifikatë për mbrojtjen nga zjarri planifikohet dhe arkëtohet nga Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimt.

Çertifikatë për mbrojtjen nga zjarri për vitin 2022 është planifikuar në vlerën **322,000 lekë** dhe është realizuar në masën **101 %** ose në vlerën **325,000 lekë**.

Gjatë vitit 2022 janë lëshuar 61 çertifikata për mbrojtjen nga zjarri prej të cilave 5 kanë qenë rinovim çertifikate dhe 56 çertifikata kanë qenë për herë të parë. Më të detajuara po i paraqesim më poshtë:

Certifikata për herë të parë

- 25 çertifikata për banesa individuale dhe kolektive
- 13 çertifikata për aktivitete të ndryshme
- 16 çertifikata për hotele dhe bujtina
- 2 çertifikata didaktike

Certifikata të rinovuara

- 5 çertifikata për bankat e nivelit të dytë dhe aktivitete
- 6 vërtetime për rënie zjarri
- 7 raste për aktivitete dhe banesa
- 11 çertifikata për autobote tregëtim karburanti

Ky realizim në këtë vlerë ka ardhur si rezultat i kërkesës për pajisje me CZS për objektet e reja si dhe objekteve ekzistuese, nga ndryshimi i destinacionit kryesisht nga banesa individuale në ndërtesa me shërbim hoteleri dhe bujtina.

MIRATIM PROJEKTI

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2022	Realizimi 2022	Përqindja
11	Miratim projekti	460,000	850,000	185 %

Tarifa për miratim projekti planifikohet dhe arkëtohet nga Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit.

Miratim projekti për vitin 2022 është planifikuar në vlerën **460,000 lekë** dhe është realizuar në masën **185 %** ose në vlerën **850,000 lekë**. Kjo tarifë arkëtohet konkretisht nga miratimi i projekteve të mbrojtjes nga zjarri për çdo lejë ndërtimi. Konkretisht janë miratuar 87 projekte të cilat më të detajuara po i paraqesim më poshtë:

- 49 projekte për banesa.
- 13 projekte për hotele

- 25 projekte për aktivitete të llojeve të ndryshme (magazina, aktivitete, didaktike, banesa)

Ky realizim në këtë vlerë ka ardhur si rezultat i aplikimit të tarifës për ndërtimet e reja si dhe ato të mbartura nga vitet paraardhëse, nga ndryshimet e destinacionit të objekteve ekzistuese kryesisht në objekte banimi në shërbime hoteleri dhe bujtina si dhe mënyrës së aplikimit të tarifave bazuar në kategorinë e tyre, lartësisë dhe sipërfaqes për aktivitet.

SHËRBIME ZJARRFIKSE NË OBJEKTE TË SIGURUARA

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2022	Realizimi 2022	Përqindja
12	Shërbime zjarrfikse në objekte të siguruara	10,000	0	-

Këto të ardhura planifikohen dhe arkëtohen nga Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit. Shërbime zjarrfikse në objekte të siguruara për vitin 2022 është planifikuar në vlerën **10,000 lekë**. Gjatë vitit 2022 nuk pati asnjë rast për të ndërhyrë në objekte të siguruara si dhe nuk u arkëtuan detyrimet për ndërhyrjet e kryera në vitet e mëparëshme.

SHËRBIME ZJARRFIKSE NDAJ TË TRETËVE

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2022	Realizimi 2022	Përqindja
13	Shërbime zjarrfikse ndaj të tretëve	40,000	0	-

Këto të ardhura planifikohen dhe arkëtohen nga Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit. Shërbime zjarrfikse ndaj të tretëve për vitin 2022 është planifikuar në vlerën **40,000 lekë**. Gjatë vitit 2022 nuk pati asnjë rast për të ndërhyrë në objekte ndaj të tretëve si dhe nuk u arkëtuan detyrimet për ndërhyrjet e kryera në vitet e mëparëshme.

MARRJE ME QIRA PYJE/KULLOTA

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2022	Realizimi 2022	Përqindja
14	Marrje me qira pyje/kullota	8,000,000	8,712,063	109 %

Këto të ardhura planifikohen dhe arkëtohen nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Pyjores.

Marrje me qira pylli për vitin 2021 është planifikuar në vlerën **8,000,000 lekë** dhe është realizuar në masën **109 %** ose në vlerën **8,712,063 lekë**. Kjo vlerë është arkëtuar nga:

- 2 kontrata qiraje të lidhura me qëllim pushim, argëtim në vlerën 204,595 lekë,
- 1 kontrata qiraje të lidhura për akuakulturë në vlerën 13,000 lekë,
- 6 kontrata qiraje të lidhura me kompanitë celulare në vlerën 1,376,205 lekë,
- 5 kontrata qiraje të lidhura për ndërtim HEC-i në vlerën 1,564,277 lekë,
- 2 kontrata qiraje të lidhura për mbjellje arrorësh në vlerën 1,723,461 lekë,
- 26 kontrata për kullotje në vlerën 1,023,900 lekë.
- 3 kontrata për gurore në vlerën 2,406,506 lekë
- 4 kontrata për anenometër në vlerën 400,119 lekë

TË ARDHURA NGA SHITJA E DRUVE TË ZJARRIT

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2022	Realizimi 2022	Përqindja
15	Të ardhura nga shitja e druve	2,500,000	2,346,060	94 %

Këto të ardhura planifikohen dhe arkëtohen nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Pyjores.

Të ardhura nga shitja e druve të zjarrit për vitin 2022 është planifikuar në vlerën **2,500,000 lekë** dhe është realizuar në masën **94 %** ose në vlerën **2,346,060 lekë**. Kjo shumë është arkëtuar nga pagesa e një kontrate shfrytëzimi e lidhur në vitin 2022.

VËRTETIME TRANSPORTI

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2022	Realizimi 2022	Përqindja
16	Vërtetime transporti	51,000	48,000	94 %

Këto të ardhura planifikohen dhe arkëtohen nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Pyjores.

Të ardhura nga vërtetime transporti për vitin 2022 është planifikuar në vlerën **51,000 lekë** dhe është realizuar në masën **94 %** ose në vlerën **48,000 lekë**. Vlerë kjo e arkëtuar nga shitja e 14

blloqe vërtetime transporti për pyll Bashkiak në vlerën 42,000 lekë dhe 1 bllok me vërtetime transporti për pyll privat në vlerën 6,000 lekë.

PRODHIME TË DYTA MEDICINALE

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2022	Realizimi 2022	Përqindja
17	Prodhime të dyta medicinale	500,000	-	-

Këto të ardhura planifikohen dhe arkëtohen nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Pyjores.

Të ardhura nga prodhime të dyta medicinale për vitin 2022 është planifikuar në vlerën **500,000 lekë** dhe gjatë vitit 2022 nuk pati asnjë arkëtim si rezultat i ndryshimit të kuadrit ligjor mbi pyjet dhe mungesës të dispozitave ligjore në zbatim të tij. Si pasojë e këtyre ndryshimeve nga ana e Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pyjeve nuk u bë e mundur lidhja e asnjë kontrate.

SHITJE DOKUMENTA ANKANDI

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2022	Realizimi 2022	Përqindja
18	Shitje dokumenta ankandi	3,000	-	-

Këto të ardhura planifikohen dhe arkëtohen nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Pyjores.

Të ardhura nga shitje dokumenta ankandi për vitin 2022 është planifikuar në vlerën 3,000 lekë dhe nuk është realizuar për arsye se nuk u realizua asnjë ankand.

GJOBË POLICIA BASHKIAKE

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2022	Realizimi 2022	Përqindja
19	Gjobë Policia Bashkiake	2,200,000	311,000	14 %

Gjoba të Policisë Bashkiake për vitin 2022 është planifikuar në vlerën **2,200,000 lekë** realizimi i saj deri në fund të vitit 2022 është në masën **14 %** ose në vlerën **311,000 lekë**.

Gjatë vitit 2022 në total janë vendosur 294 gjoba për parkim të gabuar dhe për shkelje të hapësirave publike nga subjekte tregtare (nga të cilat 287 gjoba janë vendosur për parkim të gabuar

dhe 7 gjoba janë vendosur për subjektet tregtare). Të ardhurat në vlerën 311,000 lekë janë realizuar nga arkëtimi i gjobave të vitit 2022 në vlerë 294,000 lekë dhe nga arkëtimi i gjobave të vendosura nga vitet e mëparëshme në vlerën 17,000 lekë.

GJOBË PËR VONESË NË PAGESË

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2022	Realizimi 2022	Përqindja
20	Gjobë për vonesë në pagesë	7,900,000	5,258,446	67 %

Gjoba për vonesë në pagesë për vitin 2022 është planifikuar **7,900,000 lekë** dhe realizimi i saj deri në fund të vitit 2022 është në masën **67 %** ose në vlerën **5,258,446 lekë**. Ky zë është realizuar në vlerën **5,258,446 lekë**, konkretisht :

- Nga subjektet e biznesit të madh të cilat nuk i paguan detyrimet brenda afatit të përcaktuar për vitin 2022 në vlerën 1,308,736 lekë.
- Nga subjektet e biznesit të vogël të cilat nuk i paguan detyrimet brenda afatit të përcaktuar për vitin 2022 në vlerën 1,003,574 lekë.
- Nga institucionet dhe ojf - të cilat nuk i paguan detyrimet brenda afatit të përcaktuar për vitin 2022 në vlerën 29,508 lekë.
- Nga pronarët e ndërtesave të cilët nuk i paguan detyrimet brenda afatit të përcaktuar për vitin 2022 në vlerën 227,506 lekë.
- Nga familjarët rezidentë efektivë në Njësitë Administrative të cilët nuk i paguan detyrimet e viteve të mëparëshme brenda afateve të përcaktuar në vlerën 678,985 lekë.
- Nga debitorët për vitet e mëparëshme nga subjektet e biznesit të vogël, të madh, pronarët e ndërtesave në vlerën 2,010,137 lekë.

GJOBË TË DREJTORISË SË KONTROLLIT TË TERRITORIT

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2022	Realizimi 2022	Përqindja
21	Gjobë të Drejtorisë së Kontrollit të Territorit	100,000	15,000	15%

Gjopa të Drejtorisë së Kontrollit të Territorit për vitin 2022 u planifikua në vlerën **100,000 lekë** dhe është realizuar në masën **15 %** kundrejt planifikimit ose në vlerë **15,000 lekë**.

GJOBË TË INSPEKTORIATIT NDËRTIMOR VENDOR

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2022	Realizimi 2022	Përqindja
22	Gjobë të Inspektoriatit Ndërtimor Vendor	2,000,000	2,581,858	129 %

Gjopa të Inspektoriatit Ndërtimor Vendor për vitin 2022 është planifikuar në vlerën **2,000,000 lekë** dhe realizimi i saj deri në fund të vitit 2022 është në masën **129 %** ose në vlerën **2,581,858 lekë**. Gjatë vitit 2022 nga ky inspektoriat janë likujduar 21 gjoba në vlerë 2,581,858 lekë.

GJOBË TË DREJTORISË TË TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2022	Realizimi 2022	Përqindja
23	Gjopa të D.T.T.V	360,000	20,000	6 %

Gjopa të Drejtorisë të Taksave dhe Tarifave Vendore për vitin 2022 u planifikua në vlerën **360,000 lekë** dhe është realizuar në masën 6 % kundrejt planifikimit ose në vlerë **20,000 lekë**. Konkretisht gjatë vitit 2022 janë ushtruar 667 kontrole nga specialistët e kontrollit dhe mbledhjes së të ardhurave në subjektet akomoduese nga të cilat kanë rezultuar në shkelje për mos deklarim dhe është vendosur masa e gjobës për 4 subjekte në vlerë 80,000 lekë. Ky realizim vjen si rezultat i arkëtimit të 1 gjobe të vitit 2021 në vlerën 20,000 lekë.

QIRA OBJEKTI, QIRA TRUALLI DHE QIRA TOKË BUJQËSORE

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2022	Realizimi 2022	Përqindja
24	Qira objekti, Qira trualli, Qira T. bujqësore e.t.j	20,132,390	8,549,473	42 %

Këto të ardhura planifikohen dhe arkëtohen nga Drejtoria Juridike.

Qira objekti, qira trualli, qira tokë bujqësore e.t.j për vitin 2022 është planifikuar në vlerën **20,132,390 lekë** dhe është realizuar në masën **42 %** kundrejt planifikimit ose në vlerë **8,549,473 lekë**. Konkretisht realizimi i këtij zëri në këtë nivel vjen si rezultat i :

- Arkëtimit të 6,473,739 lekë nga zëri qira trualli.
- Arkëtimit të 1,882,636 lekë nga zëri qira objekti.
- Arkëtimit të 193,098 lekë nga zëri qira tokë bujqësore.

TARIFË PËR LEJET E ZHVILLIMIT (TREGUESIT E NDËRTIMIT)

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2022	Realizimi 2022	Përqindja
25	Tarifë për lejet e zhvillimit (treguesit e ndërtimit)	450,000	520,000	116 %

Tarifë për lejet e zhvillimit planifikohet dhe arkëtohet nga Drejtoria Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit.

Tarifë për lejet e zhvillimit (treguesit e ndërtimit) për vitin 2022 është planifikuar **450,000 lekë** dhe është realizuar në masën **116 %** ose në vlerën **520,000 lekë**. Kjo tarifë është realizuar si pasojë e dhënies për 104 leje zhvillimi.

TARIFË PËR LEJË NDËRTIMI

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2022	Realizimi 2022	Përqindja
26	Tarifë për leje ndërtimi	280,000	271,000	97%

Tarifë për leje ndërtimi planifikohet dhe arkëtohet nga Drejtoria Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit.

Tarifë për leje ndërtimi për vitin 2022 është planifikuar në vlerën **280,000 lekë** dhe realizimi i saj deri në fund të vitit 2022 është në masën **97 %** ose në vlerën **271,000 lekë**. Kjo tarifë është realizuar si pasojë e dhënies për 136 leje ndërtimi.

TARIFË PËR SERVITUTIN E KALIMIT NË PRONË PUBLIKE

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2022	Realizimi 2022	Përqindja
27	Tarifë për servitutin e kalimit në pronë publike	1,195,523	680,870	57 %

Tarifë për servitutin e kalimit në pronë publike planifikohet nga Drejtoria e Kontrollit të Territorit dhe arkëtohet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Tarifë për servitutin e kalimit në pronë publike për vitin 2022 është planifikuar **1,195,523 lekë** dhe është realizuar në masën **57 %** ose në vlerën **680,870 lekë**. Realizimi i kësaj tarife vjen si rezultat i arkëtimeve të kryera nga:

- 34 subjekte që kanë paguar detyrimin për vitin 2022 në vlerën 474,091 lekë me një sipërfaqe prej 449.51 m²
- 11 subjekte debitore që kanë paguar detyrimet e viteve të mëparëshme gjatë vitit 2022 në vlerën 206,779 lekë me një sipërfaqe prej 161.85 m²

TË ARDHURA NGA QIRATË (BANESAT SOCIALE)

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2022	Realizimi 2022	Përqindja
28	Të ardhura nga qiratë (banesa sociale)	6,860,000	6,773,422	99 %

Këto të ardhura planifikohen dhe arkëtohen nga Njësia e Menaxhimit të Banesave me qëllim social.

Të ardhurat nga qeratë, (banesa sociale) për vitin 2022 është planifikuar në vlerën **6,860,000 lekë** dhe është realizuar në masën **99 %** ose në vlerën **6,773,422 lekë**.

QIRA NGA BANESAT QË KANË KALUAR NË PRONËSI TË BASHKISË KORÇË NGA ENTI KOMBËTAR I BANESAVE

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2022	Realizimi 2022	Përqindja
29	Qira nga banesat që kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Korçë nga Enti Kombëtar i Banesave	230,000	142,464	62 %

Këto të ardhura planifikohen dhe arkëtohen nga Njësia e Menaxhimit të Banesave me qëllim social.

Të ardhurat nga qiratë, (banesa në pronësi të bashkisë enti i banesave) për vitin 2022 është planifikuar në vlerën **230,000 lekë** dhe është realizuar në masën **62 %** ose në vlerën **142,464 lekë**.

KAMATË VONESA

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2022	Realizimi 2022	Përqindja
30	Kamatë vonesa	100,000	492,276	492 %

Kamatë vonesë për vitin 2022 është planifikuar në vlerën **100,000 lekë** dhe është realizuar në vlerën **492,276 lekë** ose në masën **492 %** si rezultat i zbatimit të kushteve të kontratës së qiradhënies (1% për çdo ditë vonesë nga afati i përcaktuar në kontratë).

TARIFË PËR DEPOZITIMIN E MBETJEVE INERTE

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2022	Realizimi 2022	Përqindja
31	Tarifë për depozitimin e mbetjeve inerte	2,760,000	1,871,100	68 %

Tarifë për depozitimin e mbetjeve inerte planifikohet dhe arkëtohet nga Drejtoria Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit.

Për vitin 2022 është planifikuar në vlerën **2,760,000 lekë** dhe gjatë vitit 2022 dhe është realizuar në masën **68%** ose në vlerën **1,871,100 lekë**.

TARIFË VJETORE E MIRËMBAJTJES SË SISTEMIT TË UJITJES

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2022	Realizimi 2022	Përqindja
32	Tarifë vjetore e mirëmbajtjes së sistemit të ujitjes	36,472,330	9,001,182	25%

Tarifa e mirëmbajtjes së sistemit të ujitjes planifikohet dhe arkëtohet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Është tarifa që ka kontribuar me 1 % të totalit të të ardhurave të realizuara gjatë vitit 2022.


Tarifë vjetore e mirëmbajtjes së sistemit të ujitjes për vitin 2022 është planifikuar në vlerën **36,472,330 lekë** dhe realizimi i saj deri në fund të vitit 2022 është në masën **25 %** kundrejt planifikimit ose në vlerën **9,001,182 lekë**.

Realizimi prej 9,001,182 lekë është arkëtuar i detajuar si më poshtë:

- Njësia Administrative Bulgarec ka mundur të arkëtojë gjatë vitit 2022 vlerën prej 1,406,325 lekë detyrim i vitit korent 2022 dhe vlerën prej 1,461,305 lekë detyrim ky për periudhën paraardhëse.
- Njësia Administrative Drenovë ka mundur të arkëtojë gjatë vitit 2022 vlerën prej 903,843 lekë detyrim i vitit korent 2022 dhe vlerën prej 1,005,640 lekë detyrim ky për periudhën paraardhëse.
- Njësia Administrative Mollaj ka mundur të arkëtojë gjatë vitit 2022 vlerën prej 913,205 lekë detyrim i vitit korent 2022 dhe vlerën prej 577,487 lekë detyrim ky për periudhën paraardhëse.
- Njësia Administrative Voskop ka mundur të arkëtojë gjatë vitit 2022 vlerën prej 1,135,220 lekë detyrim i vitit korent 2022 dhe vlerën prej 1,066,980 lekë detyrim ky për periudhën paraardhëse.
- Njësia Administrative Korçë ka mundur të arkëtojë gjatë vitit 2022 vlerën prej 303,730 lekë detyrim i vitit korent 2022 dhe vlerën prej 227,447 lekë detyrim ky për periudhën paraardhëse.

Më poshtë po paraqesim tabelën dhe grafikun me peshën specifike që zë secila nga të ardhurat jo tatimore kundrejt totalit të realizimit për pjesën e të ardhurave jo tatimore për vitin 2022

Nr.	Emërtimi	Në %
B	Të ardhura jotatimore	
1	Tarifë pastrimi	46%
2	Tarifë ndriçimi	10%
3	Tarifë gjelbërimi	7%
4	Tarifë mirmbajtje varreza	4%
5	Tarifë vjetore e mirëmbajtjes së sistemit të ujitjes	3%
6	Tarifa administrative	3%
7	Të tjera jo tatimore	28%



TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA

Të ardhurat nga taksat e ndara janë planifikuar në nivelin 95,870,560 lekë dhe janë realizuar në nivelin 92,743,036 lekë ose 97 % e planifikimit. Planifikimi në këtë masë ka ardhur si pasojë e planifikimit të agjentëve tatimorë të cilët planifikojnë dhe mbledhin këto të ardhura për llogari të pushtetit vendor. Duke ju referuar treguesve të detajuar të të ardhurave nga taksat e ndara, rritja në raport me një vit më parë është 4 % ose e shprehur në shifra 3,478,480 lekë.

Të detajuara paraqiten si më poshtë:

TAKSA MBI KALIMIN E SË DREJTËS SË PRONËSISË PËR PASURITË E PALUAJTSHME

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2022	Realizimi 2022	Përqindja
1	Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme	26,605,945	20,402,160	77 %

Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme e cila planifikohet dhe mbledhet nga agjenti tatimor i cili është ZVRPP Korçë.

Për vitin 2022 është planifikuar në vlerën **26,605,945 lekë** dhe është realizuar në masën **77 %** ose e shprehur në vlerë **20,402,160 lekë**. Arkëtimet për këtë taksë kalohen çdo muaj referuar akt-rakordimeve mujore mbi bazën e numrit dhe vlerës të pasurive të paluajtshme objekt transaksioni.

TAKSË E REGJISTRIMIT TË PËRVITSHËM TË MJETEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2022	Realizimi 2022	Përqindja
2	Taksa e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve të transportit rrugor	40,028,515	44,057,543	110 %

Taksa e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve të transportit rrugor e cila planifikohet dhe mbledhet nga agjenti tatimor i cili është D.R.SH.T.RR Korçë, për vitin 2022 është planifikuar **40,028,515 lekë** dhe është realizuar në masën **110 %** ose në vlerë **44,057,543 lekë**. Arkëtimet për këtë taksë kalohen çdo muaj referuar akt-rakordimeve mujore mbi numrin e mjeteve dhe vlerën e taksës për çdo mjet.

RENTA MINERARE

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2022	Realizimi 2022	Përqindja
3	Renta minerare	236,100	549,188	233 %

Të ardhura nga renta minerare për vitin 2022 është planifikuar në vlerën **236,100 lekë** dhe është realizuar në vlerën **549,188 lekë** ose në masën **233 %**. Renta minerare arkëtohet në rastin e shitjes

së produkteve minerare brenda vendit ose në rastin e eksportit të produkteve minerare. Baza e taksës janë burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka çdo person fizik apo juridik, në çastin kur ai shet produktin. Struktura e mbledhjes e kësaj takse janë: degët e doganave në rrethe të cilat ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente në rastin e eksportit të produkteve minerare, ndërsa degët e tatimeve ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e shitjes së produkteve minerare brenda vendit. Ky zë është realizuar në vlerën **549,188 lekë**, konkretisht nga:

- Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë në vlerën 382,098 lekë
- Drejtoria e Doganave në vlerën 60,547 lekë
- Tatimpaguesit e Mëdhenj në vlerën 106,543 lekë

DIVIDENTI NGA U.K.KO

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2022	Realizimi 2022	Përqindja
4	Dividenti nga U.K.KO	5,000,000	2,801,366	56%

Të ardhura nga Dividenti U.K.KO për vitin 2022 është planifikuar në vlerën **5,000,000 lekë** dhe është realizuar në vlerën **2,801,366 lekë** ose në masën **56 %**. Ky realizim në këtë masë vjen si rezultat i kalimit të dividendit për llogari të Bashkisë Korçë nga U.K.KO për vitin 2021 në vlerën 2,801,366 lekë.

TË ARDHURA NGA TATIMI MBI TË ARDHURAT PERSONALE


Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2022	Realizimi 2022	Përqindja
5	Të ardhura nga tatimi mbi të ardhurat personale	24,000,000	24,932,778	104 %

Planifikimi për tatimin mbi të ardhurat personale është bazuar në Ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 25, pika 2, të ardhurat e arkëtuara nga Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë për tatimin mbi të ardhurat personale do të ndahen me njësitë e qeverisjes vendore dhe 2% i të ardhurave nga kjo taksë për pjesën takuese i ka kaluar Bashkisë Korçë. Realizimi në masën

24,932,778 lekë tatim mbi të ardhurat personale përfshin dhe detyrimin për vitet paraardhëse por që kaloi përgjatë vitit 2022.

Më poshtë po paraqesim tabelën dhe grafikun me peshën specifike që zë secila nga taksat e ndara kundrejt totalit të realizimit për pjesën e taksave të ndara për vitin 2022

Nr.	Emërtimi	Në %
C	Taksa të ndara	
1	Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme	22%
2	Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura	48%
3	Renta minerare	1%
4	Dividenti nga U.K.KO	3%
5	Tatim mbi të ardhurat personale	27%



▪ **Transferta e pakushtëzuar, transferta e pakushtëzuar sektoriale dhe transferta specifike 2022**

Transferta e pakushtëzuar është përdorur për financimin e ushtrimit të funksioneve dhe kompetencave të përcaktuara me ligj, ndërsa transferta e pakushtëzuar sektoriale për financimin e funksioneve të transferuara në vitin 2016 si: Arsimi bazë dhe parashkollor, Konviktet e arsimit parauniversitar, Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile, Administrimi i pyjeve dhe kullotave etj, të paraqitura të detajuara sipas tabelës së mëposhtme:

000/lekë

Transferta e pakushtëzuar sektoriale			
Funksionet	2020	2021	2022
Arsimi bazë dhe parashkollor	175,003	189,254	194,261
Konviktet e arsimit parauniversitar	21,881	21,881	22,114
Arsimi i mesëm i përgjithshëm	18,290	18,838	19,592
Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	29,092	29,964	31,163
Administrimi i pyjeve dhe kullotave	13,815	15,197	15,805
Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	43,178	45,737	47,566
Rrjeti rrugor rural	6,521	6,521	7,067
Total	307,780	327,392	337,568


Këto funksione kanë pasur një rritje nga viti në vit dhe konkretisht krahasuar me vitin 2020, transferta e pakushtëzuar sektoriale e vitit 2022 ka një rritje prej 9.7% dhe krahasuar me vitin 2021 ka një rritje prej 3.1%.

Transferta e pakushtëzuar dhe transferta e pakushtëzuar sektoriale 2020-2022 paraqitet në tabelë dhe grafiki si më poshtë:

000/lekë

Burimi i të ardhurave	2020	2021	2022	% 22 / 21	% 22 / 20
Transferta e pakushtëzuar	449,034	453,082	462,077	102%	103%
Transferta e pakushtëzuar sektoriale	307,780	327,392	337,568	103%	110%
Transferta specifike për emergjenca civile		13,691			
Total	756,814	794,165	799,645	101%	106%

Tabela: Transferta e pakushtëzuar, transferta e pakushtëzuar sektoriale dhe transferta specifike për periudhën 2020-2022



Grafiku: Transferta e pakushtëzuar dhe transferta e pakushtëzuar sektoriale 2020-2022

Transferta e pakushtëzuar për vitin 2022 në krahasim me vitin 2021 ka një rritje prej 8,995 mijë lekë ose 2 % dhe në krahasim me vitin 2020 një rritje prej 13,043 mijë lekë ose 3 %.

Transferta e pakushtëzuar sektoriale për vitin 2022 në krahasim me vitin 2021 ka një rritje prej 10,176 mijë lekë ose 3 % dhe në krahasim me vitin 2020 një rritje prej 29,788 mijë lekë ose 10%.

✓ **Transferta e kushtëzuar 2022**

Transfertat e kushtëzuara janë përdorur nga Bashkia për financimin e realizimit të funksioneve të deleguara dhe të përbashkëta nga njësia qendrore. Gjatë vitit 2022 nga buxheti i shtetit janë financuar përveç funksioneve të deleguara dhe:

- Fonde për ndihmën ekonomike dhe PAK planifikuar në vlerën 642,185 mijë lekë dhe realizuar 608,844 mijë lekë,
 - Fonde për ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror plani 7,909 mijë lekë dhe realizimi 4,695 mijë lekë,
 - Bursa, kuota ushqimore, veshmbathje për arsimin parauniversitar dhe arsimin profesional planifikuar në vlerën 46,150 mijë lekë dhe realizuar 40,447 mijë lekë, si dhe
 - Bonus i qerasë në fushën e strehimit planifikuar dhe realizuar në të njëjtën vlerë 741 mijë lekë.
- Përveç këtyre fondeve janë dhënë dhe fonde për realizimin e investimeve.

Për objektin “**Ndërhyrje për shmangien e përmytjeve dhe erozionit**” sipas të cilës bashkia planifikoi në buxhetin e saj nga taksat dhe tarifat vendore 10% të projektit, pra në vlerën 6,132,026 lekë dhe fondi nga buxheti I shtetit 55,188,232 lekë. Vlera e kontratës dhe realizimi i këtij objekti ka qenë 41,257,208 lekë.

“**Rikonstruksioni dhe shtesë e shkollës së mesme “Themistokli Gërmenji**”. Vlera e kontratës për këtë objekt është 75,565,671 lekë. Ky investim është planifikuar me bashkëfinancim me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe e planifikuar me 2 vite buxhetore dhe konkretisht: Gjatë vitit 2022 kontributi nga buxheti i shtetit, e cila dhe është realizuar ka qenë në vlerën 29,691,760 lekë dhe fondi i planifikuar për vitin 2022 nga bashkia Korçë ka qenë 18,891,418 lekë nga e cila është realizuar 543,049 lekë. Ky investim vazhdon punimet dhe në vitin 2023, ku kontributi nga MASR është 26,982,493 lekë dhe kontributi i Bashkisë (2022-2023) është 18,351,369 lekë.

Gjatë vitit 2022 Bashkia Korçë ka përfituar fonde të kushtëzuara **për Mbrojtjen Civile** në vlerën 25,321,378, e cila u përdor sipas shpenzimeve të miratuara në Këshillin Bashkiak dhe konkretisht ky fond u përdor:

Shpenzime karburanti 7,861,378, lekë

Blerje pajisjesh profesionale për punonjësit e MZSH 4,512,120 lekë,

Blerje e uniformave profesionale për punonjësit e sektorit të pyjeve dhe MZSH-së 2,912,400 lekë

Shpenzime për blerje kripe 4,326,000 lekë

Rehabilitimin e rrugës autopsyjore Voskopojë-Shën Kostandin 3,082,262 lekë

Ndërtimin e pritave malore në fshatin Nevecisht 2,627,163 lekë

“**Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra**”. Vlera e kontratës për këtë objekt është 12,024,262 lekë. Ky investim është planifikuar me bashkëfinancim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe e planifikuar me 2 vite buxhetore dhe konkretisht: Gjatë vitit 2022 kontributi nga buxheti i shtetit, e cila dhe është realizuar ka qenë në vlerën 6,590,932 lekë dhe fondi i planifikuar për vitin 2022 nga bashkia Korçë ka qenë 4,208,492 lekë e cila është realizuar 100%. Kontributi nga Buxheti i shtetit për vitin 2023 është 1,224,838 lekë , e cila u shlye gjatë vitit 2023.

✓ **Të ardhurat e Institucioneve të Varësisë 2022**

Të ardhurat nga shërbimet që ofrojnë Institucionet e Varësisë u planifikuan në vlerën 23,993 mijë lekë. Këto të ardhura u realizuan në vlerën 17,319 mijë lekë ose në masën 72%.

✓ **Sponsorizimet dhe të ardhura të tjera 2022**

Gjatë vitit 2022 Bashkia, Qendra e Artit dhe Kulturës, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Shtëpia e Foshnjës dhe Klubi Shumësportësh kanë realizuar disa nga shpenzimet e tyre me të ardhura nga

sponsorizimet. Sponsorizimet janë përdorur me të njëjtin destinacion për të cilin janë derdhur në Bashki. Realizimi si më poshtë:

000/lekë

Institucioni	Sponsorizime	Fakt
Qendra e Artit dhe Kulturës	700	700
Klubi Shumësportësh	2,520	735
Ndërmarrja e shërbimeve Mbeshtetese te arsimit dhe Cerdhes	504	
Ndërmarrja e Shërbimeve Publike	2,206	1,277
Shtëpia e Foshnjës	10	1
Total	5,940	2,713

Tabela: Realizimi i sponsorizimeve 2022

3.1 Analiza e detajuar e shpenzimeve për vitin 2022

Buxheti fillestar vjetor i vitit 2022 ka qenë në vlerën 1,889,324 mijë lekë, i miratuar me VKB nr. 147 datë 22.12.2021. Ky buxhet pësoi ndryshime pas zbatimit të VKB nr. 21 datë 10.02.2022 “Për përdorimin e të ardhurave të trashëguara të vitit 2021 të Bashkisë, Institucioneve të Varësisë në buxhetin e vitit 2022. Pas ndryshimeve të bëra si më sipër, si dhe nga financimet e ndryshme të hyra në Bashki nga grande apo sponsorizime të tjera, ky buxhet shkoi në vlerën 2,138,790 lekë. Realizimi i buxhetit të vitit 2022 ka qenë 1,607,320 mijë lekë ose realizuar në masën 75% .

Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve të buxhetit sipas institucioneve, sipas artikujve buxhetore dhe sipas programeve, paraqitet si më poshtë:

000/lekë

Institucioni	Fakt 2021	Buxheti vjetor 2022		Fakt 2022	% e realizimit
		Plan fillestar	Plan përfundimtar		
Bashkia	570,969	844,782	1,051,477	635,134	60%
Ndërmarrja e Shërbimeve Publike	419,934	492,926	505,683	441,631	87%
Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes	382,606	416,991	438,819	412,557	94%

Qendra e Artit dhe Kulturës	65,336	82,661	87,956	74,513	85%
Klubi Shumësportësh	38,675	46,029	48,549	40,720	84%
Njësia e Menaxhimit të Banesave me Qëllim Social	2,239				
Shtëpia e Foshnjës	2,655	5,015	5,386	1,878	35%
Qendra Rezidenciale e Zhvillimit	1446	420	420	412	98%
Qendra Ditore	355	500	500	475	95%
Total	1,484,215	1,889,324	2,138,790	1,607,320	75%

Tabela: Realizimi i shpenzimeve të buxhetit të Bashkisë Korçë dhe Institucioneve të Varësisë

Institucionet të cilat kanë bërë të mundur realizimin e buxhetit në nivel të kënaqshëm dhe të qëndrueshëm janë Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse e Arsimit dhe Cerdhes, Klubi Shumësportësh si dhe Qendra e Artit dhe Kulturës.

000/lekë

Artikulli buxhetor	Fakt 2021	Buxheti vjetor 2022		Fakt 2022	% e realizimit
		Plan fillestar	Plan perfundimtar		
Shpenzime per paga (600)	558,642	635,670	632,568	592,172	94%
Shpenzime per sigurime shoqerore/shendetsore (601)	93,665	106,722	109,101	99,233	91%
Shpenzime operative dhe shërbime (602)	544,719	679,089	697,747	579,270	83%
Subvencione (603)	9,998	10,000	10,000	9,999	100%
Transferta tek organizatat (604)	119,650	157,565	176,024	111,782	64%
Transferta tek individet (606)	6,043	6,630	31,706	24,558	77%
Fondi rezerve + kontigjences (609)		20,000	20,000		0%
Hartim projektesh dhe oponenta teknike (230)	183	42,696	28,262	2,506	9%
Shpenzime per investime (231)	105,900	185,782	388,212	144,367	37%
Principali (166)	41,860	42,620	42,620	40,931	96%
Interesi (651)	3,555	2,550	2,550	2,502	98%
Total	1,484,215	1,889,324	2,138,790	1,607,320	75%

Tabela : Realizimi i shpenzimeve sipas artikujve buxhetore

Nga tabela e mësipërme shohim realizimin e buxhetit sipas llogarive ekonomike ku një përqindje të lartë realizimi kanë shpenzimet e personelit për paga dhe sigurime, subvencioni, shlyerja e kredisë, shpenzimet operative dhe shërbimet. Shlyerja e kredisë është prioritare gjatë kryerjes së shpenzimeve, ku gjatë vitit 2022 është shlyer pjesa e principalit dhe interesit të marrë tek Procredit Bank. Arsyet e mosrealizimit të shpenzimeve për investimeve janë për shkak të problematikave të hasura gjatë realizimit të projekteve, mosrealizimi i fondeve të planifikuara për shpronësime etj.

000/lekë

Programet buxhetore	Institucioni	Fakt 2021	Buxheti vjetor 2022		Fakt 2022	% e realizimit
			Plan fillestar	Plan përfundimtar		
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi (01110)	Bashkia	93,793	160,896	155,731	119,210	77%
Çështje financiare dhe fiskale (01120)	Bashkia	47,928	66,528	65,005	54,074	83%
Gjendja civile (01170)	Bashkia	17		99	31	31%
Pagesa për shërbimin e borxhit të brendshëm (01710)	Bashkia	45,415	45,170	45,170	43,434	96%
Shërbimet e Policisë Vendore (03140)	Bashkia	8,848	14,371	14,488	10,895	75%
Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile (03280)	Bashkia	31,259	36,270	68,448	41,808	61%
Mbështetje për zhvillimin ekonomik (04130)	Bashkia	5,725	31,998	94,152	47,618	51%
Shërbimet bujqësore, inspektimi, ushqimi dhe mbrojtja e konsumatorëve (04220)	Bashkia	2,243	987	2,739	1,691	62%
Menaxhimi i infrastrukturës i ujitjes dhe kullimit (04240)	Bashkia, NSHP	37,731	47,566	58,655	51,140	87%
Administrimi i pyjeve dhe kullotave (04260)	Bashkia	42,820	26,859	66,827	22,219	33%
Rrjeti rrugor rural (04520)	Bashkia, NSHP	14,466	77,067	69,580	6,121	9%
Transporti publik (04570)	Bashkia	10,642	13,050	13,076	10,548	81%
Zhvillimi i turizmit (04760)	Bashkia, NSHP	12,839	48,681	52,038	23,908	46%

Fondi rezerve (04910)	Bashkia	-	10,000	10,000		0%
Fondi i kontigjences (04940)	Bashkia	-	10,000	10,000		0%
Menaxhimi i mbetjeve (05100)	Bashkia	132,653	120,009	130,603	114,900	88%
Ndërgjegjësimi mjedisor (05630)	Bashkia	1,607	2,284	2,341	2,237	96%
Planifikimi Urban Vendor (06140)	Bashkia	11,806	29,272	45,643	20,401	45%
Shërbime publike vendore (06260)	Bashkia, NSHP	321,395	363,056	366,224	326,899	89%
Ndriçim rrugësh (06440)	NSHP	59,623	80,286	94,565	62,567	66%
Sport dhe argëtim (08130)	Bashkia, Klubi Shumësportësh	107,545	125,135	133,488	105,480	79%
Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore (08220)	Bashkia, QAK	68,608	82,661	114,000	85,393	75%
Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor (09120)	Bashkia, NSHMAC	309,158	316,442	335,889	314,834	94%
Arsimi i mesëm i përgjithshëm (09230)	Bashkia, NSHMAC	45,093	85,882	84,990	57,296	67%
Konviktet e arsimit parauniversitar (09230)	NSHMAC	21,384	22,114	26,108	23,726	91%
Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara (10140)	Bashkia, QDZH, QRZH	12,649	14,344	14,986	14,230	95%
Sigurimi shoqëror (10220)	Bashkia	1,549	4,384	7,392	5,769	78%
Kujdesi social për familjet dhe fëmijët (10430)	Bashkia, NSHMAC, Shtëpia e Foshnjës	30,533	39,413	41,819	33,033	79%
Strehimi social (10661)	Bashkia, NJMBQS	6,886	14,599	14,734	7,858	53%
Total		1,484,215	1,889,324	2,138,790	1,607,320	75%

Tabela: Realizimi i shpenzimeve sipas programeve buxhetore

Nga tabela e mësipërme ku paraqiten planet dhe realizimi sipas programeve dhe institucioneve, shohim që programet buxhetore kanë një përqindje të qëndrueshme realizimi kundrejt planit. Përqindjet më të lartë të realizimit kanë programet si : Pagesa për shërbimin e borxhit të brendshëm 96%, Arsimi bazë dhe parashkollor 94%, Shërbime publike vendore 89%, Menaxhimi i Infrastrukturës i Ujitjes dhe Kullimit 87%, Çështje financiare dhe fiskale 83% etj.

- Analiza e shpenzimeve Bashkia

Bashkia ka buxhetuar dhe realizuar 26 programe, të cilat do të jepen përgjatë materialit. Ky buxhet ka qenë i planifikuar në vlerën 1,051,477 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 635,134 mijë lekë ose në masën 60 %. Realizimi në përqindje sipas natyrës së shpenzimeve ka qenë:

- Shpenzime personeli: 92 %
- Shpenzime korrente: 68 %
- Shpenzime kapitale: 32 %

Ky buxhet paraqitet i detajuar sipas programeve dhe sipas natyrës së shpenzimeve si më poshtë:

000/lekë

Programet buxhetore	Shpz për personelin (600+601)		Shpz korrente (602-609,166,651)		Shpz kapitale (230-231)		TOTAL		% e realiz
	Plani përfundimtar	Fakt	Plani përfundimtar	Fakt	Plani përfundimtar	Fakt	Plani përfundimtar	Fakt	
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi (01110)	63,779	62,827	85,414	50,049	6,539	6,333	155,732	119,209	77%
Çështje financiare dhe fiskale (01120)	49,003	45,680	14,802	8,394	1,200		65,005	54,074	83%
Gjendja civile (01170)			99	31			99	31	31%
Pagesa për shërbimin e borxhit të brendshëm (01710)			45,170	43,433			45,170	43,433	96%
Shërbimet e Policisë Vendore (03140)	11,455	8,487	3,032	2,407			14,487	10,894	75%
Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile (03280)	29,160	27,486	11,897	4,704	27,391	9618	68,448	41,808	61%

Mbështetje për zhvillimin ekonomik (04130)			34,560	3,638	59,591	43,980	94,151	47,618	51%
Shërbimet bujqësore, inspektimi, ushqimi dhe mbrojtja e konsumatorëve (04220)	1,378	1,364	708	327	653		2,739	1,691	62%
Menaxhimi i Infrastrukturës i Ujitjes dhe Kullimit (04240)					2,161	26	2,161	26	1%
Administrimi i pyjeve dhe kullotave (04260)	12,925	8,649	2,880	1,314	51,022	12,257	66,827	22,220	33%
Rrjeti rrugor rural (04520)					61,791		61,791	0	0%
Transporti publik (04570)	531	530	12,545	10,019			13,076	10,549	81%
Zhvillimi i turizmit (04760)			12,773	8,675	39,265	15,233	52,038	23,908	46%
Fondi rezervë (04910)			10,000				10,000	0	0%
Fondi i kontigjencës (04940)			10,000				10,000	0	0%
Menaxhimi i mbetjeve (05100)	643	643	129,960	114,257			130,603	114,900	88%
Ndërgjegjësimi mjedisor (05630)	1,857	1,857	484	381			2,341	2,238	96%
Planifikimi Urban Vendor (06140)	13,560	10,869	6,048	2,964	26,035	6,568	45,643	20,401	45%
Shërbime publike vendore (06260)	550	546	4,714	4,524			5,264	5,070	96%
Ndriçim Rrugësh(06440)					14,124		14,124	0	0%
Sport dhe argëtim (08130)			82,335	62,893	2,604	1,867	84,939	64,760	76%
Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore (08220)					26,044	10,880	26,044	10,880	42%
Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor (09120)			1,626	966	2,734		4,360	966	22%

Arsimi i mesëm i përgjithshëm (09230)			312	87	27266	3282	27,578	3,369	12%
Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara (10140)	12,572	12,493	1494	850			14,066	13,343	95%
Sigurimi shoqëror (10220)			7,392	5,769			7,392	5,769	78%
Kujdesi social për familjet dhe fëmijët (10430)	8,122	6,814	4,535	3,305	7		12,664	10,119	80%
Strehimi social (10661)	2,942	2,521	1,769	1082	10,024	4,255	14,735	7,858	53%
TOTAL	208,477	190,766	484,549	330,069	358,451	114,299	1,051,477	635,134	60%

Tabela: Shpenzimet sipas programeve dhe llogarive ekonomike për Bashkinë Korçë

Fondi i planifikuar për paga dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore për vitin 2022 ka qenë në vlerën 208,477 mijë lekë dhe realizimi 190,766 mijë lekë ose realizuar në masën 92 %.

Numri i punonjësve faktik të Bashkisë për vitin 2022 ka qenë 262, i detajuar si më poshtë:

	Viti 2022
Bashkia	204
Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi	32
Shërbimi i Administrimit të Pyjeve	14
Gjendja Civile	11
QKB	1
Total	262

Fondi i planifikuar për shpenzime korrente për vitin 2022 ka qenë në vlerën 484,549 mijë lekë dhe realizimi 330,069 mijë lekë ose realizuar në masën 68%. Tek ky fond janë përfshirë shpenzimet operative, shpenzime mirëmbajtjeje, shpenzime për realizimin e projekteve, shërbimi i pastrimit, shërbimi urban, shërbimi i mirëmbajtjes së varrezave publike dhe të dëshmorëve, transfertat për organizata të ndryshme, transfertat për individët, pagesa për principalin dhe interesin e kredisë si

dhe fondi rezervë dhe fondi i kontigjencës. Të gjitha këto shpenzime do të jepen të detajuara përgjatë materialit.

Tabela e detajuar e shpenzimeve operative jepet si më poshtë:

000/lekë

Nr.	Emertimi i Shpenzimit	Fakti 2021	Pl 2022	Det 2021	Pl+Det	Fakti 2022	% e realiz
1	Telekom +posta	2,595	2,900		2,900	2,405	83%
2	Abonim internet ADSL dhe Central Telefonik	526	518		518	414	80%
3	Energjia elektrike Bashki	4,698	9,885		9,885	6,406	65%
4	Pagese e konsumit të ujit	1,007	930		930	700	75%
5	Gazi lengshem per ngrohje	28	72	28	100	28	28%
6	Karburant makina	4,835	10,685		10,685	7,657	72%
7	Riparim dhe pajisje makinash	806	1,667	356	2,023	1,249	62%
8	Larje automjete		229		229	64	28%
9	Siguracion makine, ndertese	218	330		330	219	66%
10	Shërbim për monitorimin e flotës së makinave		528		528		0%
11	Sigurim I banesave sociale/prone		269		269	252	94%
12	Mirembajtje dhe Certifikimi I ashensoreve	237	625	138	763	663	87%
13	Pjese kembimi ashensoret		120		120	120	100%
14	Mirembajtje dhe mbushje e fikseve te zjarrit	27	27	27	54	54	100%
15	Mirembajtje sistematike dhe urgjente e banesave sociale		250	41	291	255	88%
16	Taksa vjetore për mjetet e përdorura TVMP dhe kontrolli teknik SGS	338	260		260	118	45%
17	Materiale elektrike		1,103		1,103	764	69%
18	Materiale hidraulike		250		250	210	84%
19	Shpenzime pritje	99	120		120	99	83%
20	Veshje, uniforma policie	203	910		910	639	70%
21	Blerje radiomarrese		-		-		

22	Shpenzime per sherbimin e marrjes se frekuences per radiomarreset		35		35	33	94%
23	Shpenzime udhetimi brenda dhe jashte	1,179	2,160		2,160	1,992	92%
24	Materiale konsumi	458	520		520	301	58%
25	Materiale konsumi per dezinfektim dhe pastrim		150			41	
26	Shpenzime per te tjera materiale dhe sherbime	344	930		930	603	65%
27	Leter shkrimi fotokopimi Kancelari	1,325	1,277	178	1,455	1,146	79%
28	Boje printeri e fotokopjues	735	2,099		2,099	923	44%
29	Riparim fotokopje dhe pajisje te ndryshme	357	450	473	923	473	51%
30	Mirembajtje e instrumentit Leica total station TCR 407		288		288	288	100%
31	Bllaqe administrative	36	150		150	3	2%
32	Bllaqe administrative letra me vlere	2,596	3,450		3,450	3,398	98%
33	Shpenzime mirembajtje tregu I gjese se gjalle		20		20		0%
34	Sherbime te printimit (ftesa f-pal kartolina, baner, city light, kartolina, albume)	869	1,425	430	1,855	687	37%
35	Prodhim spoti promovues		200		200		0%
36	Mirembajtje Web-i		120		120		0%
37	Suport per hostimin, mail server dhe domain	100	120		120	60	50%
38	Mirembajtje e sistemit "Qyteti im"		1,920		1,920		0%
39	Mirembajtje e programit One stop shop		1,104		1,104		0%
40	Shp. Miremb. Prog. menaxhimit te taksave	888	888		888	444	50%
41	Mirembajtje e "Platformes WEB GIS"		1,397		1,397		0%
42	Larje xhamat e Bashkisë	120	120		120	100	83%
43	Vendime gjyqesore	3,567	24,557	918	25,475	12,564	49%
44	Rregjistrimi I pronave Bashki	849	3,000		3,000	337	11%
45	Aplikim ne Ministrine e Mjedisit per miratim VNM	30	300		300	30	10%
46	Pagesa e Kryepleqve te fshatit	4,109	4,200		4,200	4,153	99%
47	Pagesa per keshilltaret	6,846					98%

			7,380		7,380	7,208	
48	Shpenzime kancelari +leter per keshilltaret		65		65	35	54%
49	Shtypshkrime per keshilltaret		100		100		0%
50	Karburant makina per keshilltaret		29		29		0%
51	Vizite studimore per keshilltaret (sherbim transporti)		500		500		0%
52	Udhetime dhe dieta brenda dhe jashte vendit per keshilltaret		11		11		0%
53	Blerje boje printeri fotokopje per keshilltaret		50		50	37	74%
54	Blerje te ndryshme per keshilltaret		15		15		0%
55	Pagesa per RBS per urdhrat e bllokimit te automjeteve nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave vendore		1,000		1,000	79	8%
56	Blerje kuti dhe dosje per ruajtje te perhershme	1,115	513		513		0%
57	Vendosje e barres siguruese dhe barres hipotekore	114	3,030		3,030	52	2%
58	Festa e zones Lekas		250		250	150	60%
59	Meremetim i zyrave te informacionit me vetrata duralumini		110		110	110	100%
60	Materiale konsumi për Markatën e shijes	50	62		62	50	81%
61	Blerje gaz per Markaten e Shijes	1,313					
62	Energjia elektrike për Markatën e shijes	842	1,000		1,000	862	86%
63	Sherbimi I mirembajtjes se portave elektrike ne Markaten e Shijes		150		150		0%
64	Materiale të tjera mirëmbajtjeje në Markatën e shijes	34	5		5		0%
66	Shpenzim riparimi I dritareve Markata e shijes		43		43	36	84%
67	Shpenzime mirembajtje kaldaje		120		120		0%
68	Materiale hidraulike për Markatën e shijes		19		19		0%
69	Materiale ndricimi per Markaten e shijes		82		82		0%
70	Kolaudim I bombles se gazit Markata e shijes		17		17	17	100%
71	Pagesa e ujit për Markatën e shijes	383	500		500	335	67%
72	Blerje gazi për Markatën e shijes			702	702	550	78%

73	Shpenz. karburanti per shkollen e Maltes (blerje gazi)	665	450	107	557	530	95%
74	Shp. energji, uje, telefon per shkollen e Maltes	442	450		450	435	97%
75	Produkte farmaceutike logopedi		91		91	90	99%
76	Shpenzime karburanti per Q.K.P. M.Poter	1,150	1,500		1,500	1,150	77%
77	Energji elektrike per Q.K.P. M.Poter	120	130		130	103	79%
78	Pagesa per ujin per Q.K.P. M.Poter	75	96		96	56	58%
79	Shpenz. telefon internet per Q.K.P. M.Poter	44	45		45	45	100%
80	Materiale konsumi për Q.K.P. M.Poter	21	21		21	17	81%
81	Boje printeri e fotokopjues Q.K.P. M.Poter	7	8		8	4	50%
82	Pagese per shlyerjen e detyrimeve prane DRT te ish-komunave dhe drejtorise se rrugeve rurale	620					
83	Modifikim dhe pershtatje e pajisjeve ne zyren e informacionit		60		60	50	83%
84	Hartimi i kalendarit vjetor te eventeve te qendres ne vlere		600		600	564	94%
85	Organizimi i aktivitetit lancues te qendres ne vlere		720		720	696	97%
86	Organizimi i trajnimit pilot		540		540	528	98%
87	Punime meremetimi varrezat e deshmoreve		120		120	120	100%
88	Shpenzime per meremetime ne pallatin e sportit "Tamara Nikolla"		566		566	538	95%
89	Shpenzime varrimi per invalidin e luftes "Qemal Toska"		150		150	150	100%
90	Shpenzime blerje biletash per transportin ajror nderkombetar		200		200	41	21%
	TOTAL SHPENZIME OPERATIVE	47,020	103,356	3,398	106,604	64,530	61%
1	Shpenzime energji dhe uje (projekte)	330	1,524		1,524	544	36%
2	Shpenzime qeramarrje ambjenti (projekti)	935	3,018		3,018	2,215	73%
3	Shpenzime honorare (projekte)	513	1,890		1,890	1,550	82%
4	Shpenzime qeramarrje aparate paisje (projekte)	2,547	3,797		3,797	3,403	90%
5	Shpenzime qeramarrje te tjera (projektet)		1,170		1,170	952	81%
6	Sherbime te printimit & publikimit (projektet)	1,456	2,240	443	2,683	1,331	50%

7	Shpenzime transporti (projektet)	73	210		210	119	57%
8	Shpenzime udhëtimi (projektet)	596	970		970	182	19%
9	Shpenzime pritje-percjellje (projekte)	72	258		258	219	85%
10	Shpenzime për të tjera materiale dhe shërbime (projekte)	12	282		282	242	86%
11	Shpenzime dekorimi (projekte)	397	1,199		1,199	1,030	86%
12	Realizimi i akt promovues InClust	2,256					
13	Realizimi i trajnimeve dhe seminareve InClust	2,217					
	TOTAL SHP OPERATIVE PROJEKTE	11,404	16,558	443	17,001	11,787	69%
1	Shpenzime projektet IPA (shp qera, honorare, koktej , kancelari etj)	12	3,046		3,046	652	21%
2	Shpenzime dekorimi (B.Raiffeisen)-06	954					
	TOTAL SHPENZIME OPERATIVE BASHKIA	59,390	122,960	3,841	126,651	76,969	61%

Shpenzimet operative për vitin 2022 kanë qenë në vlerën 122,960 mijë lekë dhe 3,841 mijë lekë kanë qenë detyrimet. Këto shpenzime u realizuan në vlerën 76,969 mijë lekë ose në masën 61%. Pjesë e këtyre shpenzimeve ka qenë fondi i planifikuar për projektet në fushën e turizmit, projekte sociale etj, në vlerën 17,001 mijë lekë (443 mijë lekë detyrime) dhe realizimi në vlerën 11,787 mijë lekë (443 mijë lekë detyrime) ose 69%.

Detajimi i projekteve jepet si më poshtë:

TABELA E PROJEKTEVE 2022

Projekti	Plan 2022	Fakt 2022	Institucioni zbatues
Dita Ndërkombetare e Gruas, 8 Marsi	400,000	150,000	Bashkia Korçë
9 Maj, Dita e Europës	130,000	87,000	Bashkia Korçë
Korca Motor Show	400,000	392,000	Bashkia Korçë
Festa e Voskopojës	420,000	245,486	Bashkia Korçë
Festivali i Ushqimit / Festa e Lakrorit	678,000	426,722	Bashkia Korçë
Festa e Birrës	4,050,000	3,581,416	Bashkia Korçë
2B Fest	1,500,000	1,293,900	Bashkia Korçë
Festa e Mollës			Bashkia Korçë

	533,000	443,486	
Aktivite promovues për kopshtet komunitare	200,000	189,798	Bashkia Korçë
Pjesëmarrje në panairë kombëtare dhe ndërkombëtare	300,000	236,243	Bashkia Korçë
Kampionati i fluturimeve te lira (Korça open air)	675,000		Bashkia Korçë
Dita pa makina	304,000	204,700	Bashkia Korçë
Festa e Rakisë	370,000	301,420	Bashkia Korçë
Dita Ndërkombëtare e Tokës	160,000	150,000	Bashkia Korçë
Festa e Mjaltit	230,000	141,145	Bashkia Korçë
Ekspozita “ Rrënjet e qytetit tim”	195,500	95,300	Bashkia Korçë
Konferencë "Zëri Rinor për Qytetin"	182,000		Bashkia Korçë
Ekspozita fotografike “Korca is love”	370,000	258,269	Bashkia Korçë
Ceremonia e vlerësimit me çmimin “Gruaja e Vitit”	220,000		Bashkia Korçë
Karta për pensionistët	100,000	29,328	Bashkia Korçë
Qendër komunitare për moshën e tretë	2,484,000	1,293,041	Bashkia Korçë
Strehëza emergjente për rastet e dhunës në familje	252,000	89,025	Bashkia Korçë
24 qershor "Dita ndërkombëtare e egjiptianëve"	100,000	45,000	Bashkia Korçë
8 prill "Dita ndërkombëtare e romëve"	177,500	156,000	Bashkia Korçë
Ndërgjegjësimi i komunitetit nëpërmjet aktiviteteve sensibilizuese në luftën kundër dhunës në familje	136,900	37,296	Bashkia Korçë
Qendra ditore për fëmijë	1,776,000	1,383,284	Bashkia Korçë
Dita ndërkombëtare e PAK	214,200	114,085	Bashkia Korçë
TOTALI	16,558,100	11,343,944	

Një informacion i detajuar i projekteve që janë realizuar gjatë vitit 2022

❖ Festa e Birrës

Aktiviteti më i madh veror “Festa e Birrës 2022” këtë vit u zhvillua në sheshin e Terminalit të Autobusave dhe tek sheshi i Pazarit të Vjetër Korçë, prej datës 17 Gusht deri në datën 21 Gusht

2022. Festa u realizua me një infrastrukturë tepër të veçantë, e cila përfshinte infrastrukturën e nevojshme për realizimin e show-t të aktivitetit tek të dy ambientet (Terminali dhe Pazari), struktura dekoruese, e cila ishte e pajisur me vargje dritash led, të cilat konturuan gjithë hapësirën ku ishin vendosur tavolinat për pjesëmarrësit, duke krijuar pamje estetike dhe shumë të organizuar të gjithë hapësirës ku u zhvillua festa, hapësirat promociionale të pjesëmarrësve dhe sponsorëve të përshtatura për natyrën e festës. Përgjatë 5 netëve u realizuan performanca të shkëlqyera nga këngëtarë e grupe muzikore vendase dhe të huaja dhe nata e fundit e festës kulmoi me performancën e këngëtarit më të famshëm grek e të njohur në mbarë botën Konstantinos Argiros. Veç artistëve shqiptarë, pjesëmarrës ishin DJ dhe grupet më të njohura muzikore në Shqipëri dhe jo vetëm. Të gjitha grupet dhe këngëtarët performuan live në të 5-ta netët e festës, në të dy skenat, të cilat prisnin si çdo vit mijëra vizitorë jo vetëm shqiptarë, por edhe nga vende të ndryshme të botës.



Vlera e planifikuar e projektit: 4,050,000 Lekë

Vlera e realizuar: 3,581, 416 Lekë

❖ Pjesëmarrje në panairë kombëtare dhe ndërkombëtare

Bashkia Korçë mori pjesë dhe u prezantua në edicionin e 28^{të} të Panairit Ndërkombëtar të Tiranës, që u mbajt në datat 1 deri në 4 Dhjetor, 2022 në Pallatin e Kongreseve, Tiranë. Çdo vit, Panairi Ndërkombëtar i Tiranës është boshti i një networku të pamatë Biznesi dhe Kulture, zotuar ndaj më shumë se 250 ekspozuesve dhe mbi 19.000 vizitorëve të ardhur nga mbi 15 vende ekspozues që përfaqësojnë kompani të vëmendshme ndaj tregjeve të reja, të gatshme për të ndarë dije dhe zgjidhje të reja të zbatueshme në sektorë të ndryshëm, që nga kultura, turizmi, edukimi, ndërtimtaria, energjia e rinovueshme, bujqësia dhe industria ushqimore, tekstili dhe

industria e lehtë, siguria dhe digjitalizimi. Të pranishëm në këtë aktivitet të rëndësishëm ekonomiko-kulturor ishin Dhoma e Tregtisë e Stambollit, në përvjetorin e saj të 140-të, e cila prezantohej me kompanitë e zgjedhura që përmes Shqipërisë, shohin përtej investimet, për më thellë në Rajon. Kompanitë nga Kosova përfaqësoheshin me sektorët e industrisë së paketimit, tubave plastike, printimeve, agroushqimore etj. Bashkia Korçë u prezantua përgjatë 4 ditëve me stendën e saj, duke mundësuar brandimin e stendës me baner si edhe mbuloi koston e hapësirës për ditët e zhvillimit të panairit.

Në edicionin e këtij viti, Kryetari i Bashkisë Korçë u vlerësua nga Z.Luan Muhametaj, Presidenti i Klik Expo Group me medaljen “Shqiponja e Artë”, me motivacionin “Për kontributin e dhënë në zhvillimin ekonomik, kulturor dhe promovimin e vlerave të qytetit të Korçës”.

Panairi Ndërkombëtar i Tiranës është një nga eventet më të rëndësishëm në Ballkanin Perëndimor, duke ofruar një mundësi të mirë për kompanitë që të prezantojnë produktet e tyre, të shkëmbejnë kontakte për të bashkëpunuar në fusha të ndryshme, të eksplorojnë mundësi të reja eksporti, të forcojnë marrëdhëniet ekzistuese, dhe të krijojnë partneritete të reja biznesi, me partner si nga Shqipëria, ashtu nga rajoni dhe vende të tjera pjesëmarrëse.

Vlera e planifikuar e projektit: 300,000 Lekë

Vlera e realizuar: 236,243 Lekë




❖ **Festivali i ushqimit/ Festa e Lakrorit**

Festa e Lakrorit, një aktivitet tashmë i kthyer në një traditë të përvitshme, u zhvillua tek fusha sportive në fshatin Polenë, Njësia Administrative Voskop, ditën e shtunë, datë 6 Gusht 2022. Në

aktivitet, morën pjesë amvisa nga Polena, të cilat përgatisin lakrorin me dy petë, traditë e veçantë e zonës, si edhe biznese lokale dhe gra të zonës të cilat promovojnë punimet artizanale, zajre të zonës si edhe elementë të veçantë të traditës së kësaj zone. Risi e këtij viti është promovimi i gatimit të lakrorit në saç gjatë gjithë vitit nga amvisat në Polenë, duke ju vënë në dispozicion vizitorëve vendas dhe të huaj kontaktet e shtëpive në Polenë, ku ata jo vetëm ta shijojnë, por edhe ta shohin nga afër mënyrën e veçantë të përgatitjes së lakrorit me dy petë.

Saçi dekorativ i vendosur në qendër të hapësirës ku u zhvillua aktiviteti u dekorua sipër me imazhin e lakrorit. Ambienti përreth si edhe hapësira për realizimin e programit artistik, u ndriçua me vargje dritash dhe kuba kashte natyrale, të cilat u vendosën enkas për këtë festë, për të krijuar atmosferë festive, por edhe për të plotësuar gjithë parametrat e kërkuara për realizimin e plotë të infrastrukturës së aktivitetit.

Aktiviteti vazhdoi deri ne orët e vona të mbrëmjes me performanca muzikore live nga artistja e mirënjohur me origjinë nga Polena, këngëtarja Paola Kotani si edhe argëtimit të fëmijëve përmes lojërave të ndryshme, realizuar nga Fondacioni Kenedi. Festa e Lakrorit, një aktivitet i përvitshëm, tashmë njihet nga të gjithë dhe tërheq vëmendjen dhe pjesëmarrjen e shumë vizitorëve, duke konsoliduar traditën e gatimit të lakrorit të Korçës.



Vlera e planifikuar e projektit: 678,000 Lekë

Vlera e realizuar: 426,722 Lekë

❖ **Dita pa makina**

Bashkia Korçë në bashkëpunim me Federatën Shqiptare të Çiklizmit, Tiranë në kuadër të 22 Shtatorit “Ditës Ndërkombëtare pa makina”, me qëllim mbrojtjen e mjedisit si edhe promovimin e

jetës së shëndetshme, organizoi një garë çiklistike, me qëllimin e përbashkët për të reduktuar numrin e automjeteve në qytet.

Aktiviteti sportiv filloi në orën 10:00, tek Katedralja "Ringjallja e Krishtit" përgjatë Bulevard "Republika " me një xhiro demonstrative deri në fund të Parkut "Rinia". Në aktivitet u bashkuan përveç çiklistëve profesionistë edhe çiklistë të rinj, përfaqësues nga Bashkia, duke përcjellë tek të gjithë mesazhin për të mbrojtur natyrën dhe mjedisin duke përdorur më shumë biçikletat.

Garat çiklistike për dy kategoritë Kadete dhe Elite- U23 u zhvilluan me sukses sipas itinerarit të përcaktuar nga Federata e çiklistëve 63km dhe 94 km. Për realizimin e projektit, Bashkia Korçë mbështetur në buxhetin e miratuar për realizimin e projektit "Dita Ndërkombëtare pa makina", mbuloi koston e materialeve promocionale (baner), koston e akomodimit të 70 personave si edhe një koktej për çiklistët pjesëmarrës në përfundim të aktivitetit. Pas përfundimit të garës 63 km dhe 94 km të gjithë çiklistët pjesëmarrës u mblodhën tek Parku "Rinia", Sheshi para bar Vanesa për Ceremoninë e ndarjes së çmimeve për fituesit në kategoritë Kadete, Elite- U23 dhe Junior. Aktiviteti u përmbyll me Ceremoninë e dhënies së çmimeve tek Sheshi para bar Vanesës, Parku Rinia. Fitues të çmimeve ishin çiklistë nga ekipe të ndryshme të Shqipërisë Tirana, Elbasani, Apollonia, Besa, etj.

Vlera e planifikuar e projektit: 304,000 Lekë

Vlera e realizuar: 204,700 Lekë



❖ Festa e Mollës

Bashkia Korçë organizoi ditën e shtunë, datë 15 Tetor 2022, Ora 17:00 tek fusha sportive në Dvoran "Festën e Mollës". Aktiviteti tradicional "Festa e Mollës", promovon traditën

shumëvjeçare të Korçës në prodhimin e mollëve dhe përfshinte ndër të tjera edhe një panair, ku të gjithë fermerët reklamuan mollët si edhe pjesëmarrës të tjerë, që promovuan produkte të tjera si ushqime me mollë, produkte artizanale, etj .

Pjesë e aktivitetit "Festa e Mollës" ishte edhe vlerësimi me Çertifikata të trajnimit të zhvilluar "Mbi kontrollin biologjik të krimbit dhe kromës së mollës" për 16 fermerë e specialistë të rinj të frutave, në kuadër të programit SRD/ GIZ Albania. Për realizimin e aktivitetit, Bashkia u kujdes të promovonte aktivitetin, të realizonte dekor festiv në ambientin ku u zhvillua aktiviteti, duke krijuar një infrastrukturë të plotësuar brenda gjithë parametrave, mundësoi transportin vajtje- ardhje të qytetarëve dhe vizitorëve që frekuentuan aktivitetin, realizimin e një kokteji me ushqime tradicionale, ëmbëlsira me mollë, produkte të tjera me mollë, lëngje frutash, etj, të cilat u shpërndanë falas për të gjithë pjesëmarrësit që frekuentuan festën.

Aktiviteti vijoi deri në orët e mbrëmjes së të shtunës nën tingujt e muzikës, kërcimit, ushqimeve tradicionale të zonës dhe lojërave për fëmijët në këndin e dedikuar për ta, duke krijuar një mundësi argëtimi jo vetëm për banorët e Dvoranit dhe Njësive të tjera Administrative të Korçës, por edhe për vizitorët, të cilët kishin zgjedhur të frekuentonin Korçën gjatë fundjavës.

Festa Mollës është kthyer në traditën më të veçantë të vjeshtës, e cila jo vetëm promovon produktin vendas, por nxit turizmin në zonë e më gjerë dhe çdo vit frekuentohet, nga familjarë të Korçës dhe vizitorë vendas e të huaj, të cilët vizitojnë në këtë sezon Korçën.

Vlera e planifikuar e projektit: 533,000 Lekë

Vlera e realizuar: 443,486 Lekë



❖ Festa e Rakisë

Bashkia Korçë organizoi në Boboshticë, Njësia Administrative Drenovë, në datën 24 Shtator 2022 “Festën e Rakisë”, e cila kishte për qëllim promovimin e rakisë së manit, karakteristikë e veçantë e këtij fshati, e cila është jo vetëm një alternativë për banorët e Boboshticës, por edhe perspektivë për zhvillimin e turizmit.

Panairi me ushqime tradicionale, raki mani dhe raki të llojeve të tjera, është një ndër aktivitetet më të veçanta, me qëllim promovimin e kulinarisë, rakisë, artizanatit dhe prodhimeve lokale. Ambienti u dekorua përreth me vargje dritash, që ndriçonin gjithë hapësirën përreth dhe kuba kashte, të cilat krijonin atmosferë festive dhe dekorim të zonës. Për të gjithë personat që frekuentuan aktivitetin, Bashkia mbuloi kostot e transportit falas vajtje - ardhje.

Pjesë e aktivitetit ishte edhe fabrika e përpunimit të qumështit Shaka, në Boboshticë, e cila ofroi falas për të gjithë të pranishmit shumëllojshmëri dhe cilësi të produkteve që ofron në treg. Gatimet tradicionale të shoqëruara me raki, nën tingujt e performancës live të artistit korçar Antonio Tole, gjallëruan Boboshticën mbrëmjen e së shtunës. “Festa e Rakisë” në Boboshticë, e kthyer tashmë në një traditë, me rakinë, ushqimet tradicionale, punimet artizanale dhe bukuritë natyrore e ka shndërruar këtë fshat në një destinacion turistik të vizitueshëm nga turistë vendas dhe të huaj.



Vlera e planifikuar e projektit: 370,000 Lekë

Vlera e realizuar: 301,420 Lekë

❖ 9 Maj Dita e Europës

Me rastin e 9 Maj-it “Ditës Ndërkombëtare të Europës”, Bashkia Korçë organizoi në datën 9 Maj 2022 , tek e ambientet e Muzeut “Mësonjëtorja e Parë Shqipe” një ekspozitë fotografike.

Për realizimin e ekspozitës, Bashkia u kujdes në përzgjedhjen e një kuratori me eksperiencë në aktivitete të ngjashme si edhe realizoi dekorin, në përputhje me tematikën e aktivitetit. Gjatë zhvillimit të aktivitetit, Bashkia Korçë shpërndau për të gjithë të rinjtë e angazhuar, të cilët kontribuan në realizimin e fotove certifikata pjesëmarrje. Aktiviteti u promovua në rrjetet sociale, duke përcjellë impakt pozitiv dhe kënaqësi tek të gjithë të pranishmit dhe veçanërisht tek të rinjtë pjesëmarrës.



Vlera e planifikuar e projektit: 130,000 Lekë

Vlera e realizuar: 87,000 Lekë

❖ **Festa e Mjaltit (Dita Botërore e Bletës)**

Bashkia Korçë organizoi në kuadër të Ditës Botërore të Bletës, në datë 21 Maj 2021 “Festën e Mjaltit”, e cila u zhvillua në formën e një Panairi të Mjaltit, në datë 21 Maj 2022, Ora 11:00, në sheshin e Kullës Panoramike, me të gjithë bletërritësit e interesuar. Aktiviteti u organizua në bashkëpunim me Shoqatën e Bletërritësve të Korçës dhe në panair u ekspozuan produktet e mjaltit si edhe pajisje që ndihmojnë bletërritësit për të siguruar mjaltin dhe nënproduktet e tij, të cilat përdoren për përfitime shëndetësore. Për të krijuar atmosferë festive në vendin ku u përcaktua të zhvillohej aktiviteti “Festa e Mjaltit”, u realizua një dekor festiv, që përfshinte realizimin e dy strukturave prej druri, të cilat kishin të kompozuar mbi 15 hoje bletësh jo uniforme në formë gjashtë këndore të fiksuara dhe të ndërlidhura midis tyre dhe të dekoruara me lule dhe imazh bletësh, enkas për këtë aktivitet.

Aktiviteti “Festa e Mjaltit”, jo vetëm promovoi produktet e bletërritësve të Korçës, por edhe mundësoi shkëmbimin e eksperiencës së ndërsjelltë midis të gjithë bletërritësve pjesëmarrës. Festa e Mjaltit vjen si pjesë e aktiviteteve të larmishmë të Panairit të Pranverës, me synim për ta kthyer këtë festë në një traditë të përvitshme, duke u angazhuar për të mbështetur bletërritësit, si mundësi për të gjeneruar të ardhura nga bletaria, si sektor i zhvillimit të turizmit malor, por edhe mjekësor.



Vlera e planifikuar e projektit: 230,000 Lekë

Vlera e realizuar: 141,145 Lekë

❖ **Ekspozita fotografike “Korça is love”**

Bashkisë Korçë çeli në datën 11 Qershor 2022, në ambientet e parkut “Rinia” ekspozitën fotografike, me foto të realizuara nga fotografi i mirënjohur Albert Cmeta. Në ekspozitën fotografike u ekspozuan 30 fotografi, të cilat përfshinin jo vetëm foto të Korçës, por edhe foto nga atraksionet më të bukura turistike të saj si Dardha dhe Voskopoja, si edhe foto nga eventet më të bukura të organizuara në Korçë si Karnavalet, Festa e Birrës, etj. Në të gjitha fotografitë e shkrepura për Korçën vihej re dashuria e autorit për qytetin, i cili me shumë pasion e përcolli përmes fotografive, për të gjithë ata që Korçën e kanë dashuri.

Ekspozita fotografike u vizitua nga banorë të Korçës, artdashës, por edhe vizitorë, të cilët u njohën nga afër me veprimtarinë e fotografit Albert Cmeta, i cili përmes lentes së aparatit fotografik solli Korçën me gjithë bukuritë e saj. Kjo ekspozitë vjen pas shumë ekspozitave të tjera, që autori ka çelur kryesisht në Tiranë dhe pas shumë albumeve dhe botimeve me fotografi.

Vlera e planifikuar e projektit: 370,000 Lekë

Vlera e realizuar: 258, 269 Lekë



❖ Dita Ndërkombëtare e Tokës (Ekspozita “Elements”)

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Tokës, Bashkia Korçë organizoi në datë 28 Prill 2022, në ambientet e Parkut “Rinia”, ekspozitën fotografike “Elements”. Në ekspozitën fotografike “Elements”, u ekspozuan 20 fotografi të vendosura si instalacion në ambientet e parkut “Rinia”, për të cilin u kujdes një kurator, i cili gjithashtu mori përsipër të realizonte fotografitë profesionale sipas tematikës së aktivitetit dhe përzgjodhi në bashkëpunim me organizatorët e bashkisë fotografitë që do të ekspozoheshin në aktivitet.

Njeriu i ndërthurur me natyrën ka qenë në fokusin e kësaj ekspozite, e cila ka sjellë emocione për ata të cilët i panë këto fotografi nga afër. Ekspozita përcjell mesazhin se natyra shërben si frymëzim dhe nxitje e krijimtarisë dhe artit, duke përcjellë mesazhin se asgjë nuk mund të konsiderohet art nëse nuk vjen nga natyra.

Ekspozita fotografike “Elements” u frekuentua nga të ftuar të shumtë nga të gjitha grupmoshat, për të përcjellë mesazhin e lidhjes së fortë të njeriut me natyrën dhe kujdesin që duhet të tregojnë të gjithë ndaj natyrës dhe mjedisit ku jetojmë.



Vlera e planifikuar e projektit: 160,000 Lekë

Vlera e realizuar: 150,000 Lekë

❖ **Korça Motor Show**

Aktiviteti “Korça Motor Show” u zhvillua në datë 18 Qershor 2022, tek sheshi para Katedrales “Ringjallja e Krishtit”, me mbështetjen e “Riders Legends Korça”, me pjesëmarrjen e rreth 300 motoristëve të apasionuar nga Shqipëria dhe nga vende të tjera si Kosova, Maqedonia, Greqia, etj. Grupi i motoristëve në hapje të aktivitetit zhvilloi një paradë me motorë nga Sheshi i Katedrales “Ringjallja e Krishtit”, përgjatë Bulevardit “Republika”, më pas tek “Lëndina e Lotëve”; Bulevardit “Gjergj Kastriotit”. Parakalimi vazhdoi tek rrethrotullimi i Pazarit të Vjetër, Korçë, përgjatë Bulevardi “Fan Noli” dhe prej andej motoristët u kthyen sërish tek Sheshi i Katedrales, ku u ekspozuan mjetet motorike dhe aktiviteti vijoi me programin artistik dhe performancat rock live të grupit muzikor “Rubin Kaso & Band”. Aktiviteti "Korça Motor Show", dhuroi një super spektakël me muzikë rock, i cili zgjati deri në orët e mbrëmjes dhe u frekuentua nga banorë të Korçës, vizitorë vendas dhe të huaj, që vizitojnë Korçën gjatë fundjavës si edhe të apasionuar pas mjeteve motorike, të cilat u ekspozuan në shesh gjatë gjithë kohëzgjatjes së aktivitetit.




Vlera e planifikuar e projektit: 400,000 Lekë

Vlera e realizuar: 392,000 Lekë

❖ **2 B Bazaar Festival**

Aktiviteti “2B Bazaar Festival”, u zhvillua tek Pazari i Vjetër Korçë, prej datës 9- 11 Dhjetor 2022. Aktiviteti artistik solli përgjatë 3 netëve muzikën komerciale shqiptare dhe kontemporane, të realizuar nga DJ- ët më të mirë, të cilët performuan live për të gjithë adhuruesit e muzikës, të rinjtë si edhe vizitorët e shumtë vendas dhe të huaj që vizitojnë Korçën dhe dëshirojnë të argëtohen gjatë fundjavës. Rrugica e festave, u ndriçua përgjatë 3 netëve me projeksion dritash, ku përgjatë gjithë rrugicës për 3 netë me rradhë projektoshin efekte të ndryshme dritash dhe gjithë rrugica ndriçohet me projeksione dritash led shumëngjyrëshe. Aktiviteti artistik tre ditor tërhoqi vëmendjen jo vetëm të publikut korçar, por edhe të vizitorëve vendas dhe të huaj, të cilët ndoqën me interes përgjatë 3 netëve, performancat muzikore të DJ-ve të ftuar, duke bërë që Korça të jetë destinacioni më i frekuentuar gjatë muajit Dhjetor, që përkon me festat e fundvitit.



Vlera e planifikuar e projektit: 1,500,000 Lekë

Vlera e realizuar: 1,293,900 Lekë

❖ **Dita Ndërkombëtare e Gruas, 8 Mars**

Bashkia Korçë, në kuadër të projektit "Ditës Ndërkombëtare të Gruas", organizoi në datën 8 Mars 2022, në ambientet e Bibliotekës së re Publike "Thimi Mitko", një ekspozitë në përkujtim të kontributeve sociale, politike dhe ekonomike të grave, që kanë lënë gjurmë në historinë korçare. Në ekspozitë u paraqiten materiale dokumentare e historike (dorëshkrime, revista, gazeta, fotografi origjinale, kartolina e shënime) të shumë prej zonjave me kontribut në shoqërinë korçare e me gjerë. Përmes artefakteve u fol rreth rolit të tyre emancipues në shoqëri dhe kontributeve, që ato kanë dhënë për shkollën dhe çështjen shqiptare, brenda e jashtë vendit. Fotot e publikuara në ekspozitë përmbanin një shpjegim të shkurtër rreth jetës e veprimtarisë së tyre. Për realizimin e ekspozitës "Ylli i Mëngjesit", me materiale historike u kujdes një kurator, me eksperiencë si studiues dhe organizator i shumë aktiviteteve të tjera të rëndësishme historike, jo vetëm në Korçë por edhe në qytete të tjera të Shqipërisë, i cili në bashkëpunim me organizatorët e aktivitetit koordinuan dhe u kujdesën në detaje për mbarrëvajtjen e aktivitetit. Ekspozita përveç vlerave artistike dhe kulturore që mbart, ka edhe vlera edukative për të gjithë të ftuarit që e vizituan.



Vlera e planifikuar e projektit: 400,000 Lekë

Vlera e realizuar: 150,000 Lekë

❖ **Ekspozita "Rrënjët e qytetit tim"**

Bashkia Korçë në datën 12 Dhjetor 2022 në ambientet e Qytezës së Fëmijëve, organizoi ekspozitën fotografike “Rrënjët e qytetit tim”, e cila u ndërthur me ceremoninë e shpërndarjes së certifikatave të vlerësimit me bursë për gjimnazistët e shkëlqyer. Ekspozita fotografike "Rrënjët e qytetit tim", kishte për qëllim promovimin e vlerave turistike, arkitekturore dhe kulturore të qytetit të Korçës nga të rinjtë e apasionuar pas fotografisë. Për realizimin e aktivitetit, u kujdes një kurator me eksperiencë, i cili me mbështetjen e të rinjve pjesëmarrës realizoi fotografitë profesionale dhe në bashkëpunim me organizatorët për zgjodhi fotot më të mira për t'u ekspozuar. Për realizimin e aktivitetit, Bashkia mbuloi kostot e realizimit të printimit të 30 fotografive në material forex, certifikatave të pjesëmarrjes për nxënësit që u angazhuan si edhe kostot e kuratorit të aktivitetit. Ekspozita u vizitua nga përfaqësues nga Bashkia Korçë, institucionet publike, nxënës, e mësues nga shkollat e qytetit të Korçës si edhe të ftuar të tjerë.



Vlera e planifikuar e projektit: 195,500 Lekë

Vlera e realizuar: 95,300 Lekë

❖ **Festa e Voskopojës**

Bashkia Korçë organizoi në Voskopojë në datën 10-11 Shtator në Voskopojë, “Festën e Voskopojës”, e cila përfshinte realizimin e aktiviteteve të ndryshme gjatë dy ditëve si edhe organizimin e Edicionit të 5- të të vrapimit malor në shtigjet e Voskopojës “Trail Running Albania” për kategoritë 5km, 10km dhe 21 km.

Aktivitetet e larmishme që u zhvilluan gjatë dy ditëve kishin si qëllim promovimin e vlerave historike të Voskopojës, të artizanatit, guidën e kishave, shëtitjet me kuaj, sporteve në natyrë si edhe lojëra argëtuese për fëmijët. Panairi i Ushqimit ishte një ndër aktivitetet më të veçanta ku u ofruan gatimet tradicionale të Voskopojës, me qëllim promovimin e kulinarisë dhe traditës së

